

**N**djeshmëria ndaj dhurimit

**I** pasuri dhe i varfëri në shoqërinë Islame

**T**ë dhurosh në rrugën e Allahut

**B**ujaria dhe dhurimi

**N**jë shoqëri që di të dhurojë

**R**elikte historike

**A**ktualitet



# Sadakaja




## EDITORIAL

Zoti ynë e ka vlerësuar si një ndër obligimet shoqërore më të rëndësishme dhurimin, si rezultat i natyrshëm i nderit njerëzor dhe shprehja më fisnike e ndërgjegjeve të kulluara të mbujtura me ndjenja mëshire dhe keqardhjeje. Nuk ka dyshim se kjo është një nga favoret e Tij të veçanta. Pra Zoti i ka urdhëruar njerëzit që një pjesë të vogël të mirësive dhe begatave të kësaj jete që Ai u ka falur, t'ia kthejnë sërish Atij në shenjë falenderimi nëpërmjet dhurimit në emër të Zotit, duke e shndërruar këtë akt në një shkak për faljen e gjunaheve dhe një portë të rëndësishme që të shpie në lumturinë e përjetshme.

Bujaria është rezultat i besimit të plotë tek Allahu dhe ahireti. Sa bukur e shpreh këtë të vërtetë Aliu:

“Besimi është si një pemë, rrënja e të cilit është njohja e sigurtë, degët e saj është devotshmëria, drita e saj është turpi dhe fruti i saj është bujaria.”

T'i japësh hakun pasurisë që zotërohet është e mundur vetëm nëse njeriu nuk e shpenzon atë në vende të ndaluar fetarisht dhe duke qëndruar larg dy rreziqeve të mëdha për pasurinë që janë shpërdorimi dhe kopracia. Fatkeqësia e kamjes janë syri i pangopur, kopracia dhe dëshira për t'u pasuruar përherë e më shumë, ndërsa shërimi prej tyre arrihet nëpërmjet bujarisë.





NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

8



NDESHMËRIA NDAJ KRIJUESIT

*HASAN KAMIL JËLLMAZ*

4

I PASURI DHE I VARFËRI NË SHOQËRINE ISLAME

*AHMET TASHGETIREN*

8

THIRRJA PËR LËMOSHË  
DHE VULLNETI HYJNOR

*RIFAT KANDEMOGLU*

12

TË DHUROSH NË RRUGËN E ALLAHUT

*DOÇ. DR. FAHREDIN JËLLDËZ*

16

BABA NALLANXHIU:  
PO SULTANI Ç'PUNË BËN?

*EVANS DRISHTI*

19

RIMËKËMBJA E NJË SHOQËRIE  
MBI BAZËN E SADAKASË

*EVANS DRISHTI*

22

FETVA MBI BID'ATIN DHE VEPRIMIN ME TË

*PROF. DR. ALI XHUMAJA*

26

AJETE DHE HADITHE

30

12



32



# Mars - Prill 2009

BUJARIA DHE DHURIMI

*OSMAN NURI TOPBASH*

32

SIGURIMET BASHKËKOHORE

DHE QËNDRIMI I SHERIATIT ISLAM NDAJ TYRE

*MR. FLAMUR SOFIU*

40

HAXHI SHEH MUHAMED SHABAN EFENDI DOMNORI

*ISLAM DIZDARI*

44

NJË SHOQËRI QË DI TË DHUROJË

*ALI HYSREVOGLU*

48

PREZANTIM LIBRI

*NAIM DRIJAJ*

50

RELIKTE HISTORIKE

*SAMIR RAMJA*

52

TEKNOLOGJI

54

SHËNDETI DHE FAMILJA

56

AKTUALITET

58

40



48



50



Viti: III Numri: 18

- Maj - Qershor 2009
- Xhemadul evvel - Xhemadul ahir 1430

Boton

- Progresi sh.p.k.
- Shkodër / Shqipëri

Përkthyes

- Arjan Ymeri
- Ermal Nurja
- Evans Drishti
- Fatmir Sulaj
- Ilir Hoxha
- Ilir Rruja

Redaktor

- Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik

- Bledar Xama
- [bledar\\_xama@hotmail.com](mailto:bledar_xama@hotmail.com)

Ngjyra

- Progresi

Adresa

- L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
- Shkodër
- Tel: +355 22 254 533
- Fax: +355 22 254 534
- Cel: +355 20 76768 / +355 20 86767

Shtyp

- ArbëriaDesign, Tetovë
- Tel: +389 44 35 33 71
- Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj


- e-mail: [revistaetika@progresibotime.com](mailto:revistaetika@progresibotime.com)
- e-mail: [kosova@progresibotime.com](mailto:kosova@progresibotime.com)

Çmimi

- 1 Euro
- 150 Lek
- 60 DEN



# Ndjeshmëria ndaj dhurimit



**D**obësia dhe pasioni i birit të njeriut ndaj bukurive të kësaj bote është e lindur. Sikur toka që ndjen mall dhe dashuri për ujin, ashtu edhe njeriu, lënda e parë e të cilit është toka, ndjen mall dhe dashuri për bukuritë e saj, i thith dhe i mban

ato. Sikur bimët e dobishme që dalin nga toka e aftë për të thithur ujin ashtu edhe përvetësimi i bukurive dhe të mirave të kësaj bote prej njeriut duhet të japin prodhime të dobishme sikur të tokës.

Përgjegjësia që ka njeriu kundrejt bukurive dhe të mirave të kësaj bote, në Kur'an shprehet me fjalë të ndryshme. Nga këto, më të përdorurat janë sadaka dhe tasadduk, nafaka dhe infak, zekat, xhud dhe isar.

Sadaka, është ajo që njeriu jep vullnetarisht me qëllim që t'i afrohet All-llahut. Të japësh sadaka do të thotë "tasadduk". Ndonjëher kur kushtet që kërkohen për t'i dhënë zekatin dikujt nuk ndryshojnë bëhet sebeb që edhe zekati të quhet sadaka.

Zekat, do të thotë pastrimi i një malli që shtohet dhe beгатohet. Pra zekat, është taksa që ka ndarë njeriu si urdhër i All-llahut dhe e drejtë e të varfërit. Zekati pastron dhënësin prej sëmundjes së kopracisë por edhe mallin prej dyshime-


ve. Gjithashtu edhe sadakaja ka veti pastruese. All-llahu Teala urdhëron: *"Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t'i pastrosh me të dhe t'u shtosh (të mirat)...!"* (Tevbe 103)

Infak, janë harxhimet dhe kursimet që bëhen në mall apo në gjëra të tjera. Në këtë ka dhe farze (obligime) por edhe nafike (vullnetare). Kurse "Nafaka" përdoret për atë që bëhet infak (dhurohet).

Xhud, është shpërndarja e mallit dhe diturisë që zotërohet. Do të thotë që, dikush të mos ketë vështirësi të harxhojë mallin dhe pasurinë e tij. Këtu bëhet fjalë për gjëra sikur malli, trupi, posti, kjo botë dhe bota tjetër.


Isar, do të thotë kur në vend të vetes i jep përparësi dhe zgjedh një tjetër. Me të vërtetë edhe ky ajet është tregues i kësaj; *"... madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes..."* (Hashr, 9)

Prej këtyre nocioneve që përmendëm "Infak" është më



*"Të pyesin se ç'do të japin. Thuaj: "Atë që jepni prej pasurisë jepni për prindërit, jepni për të afërmit, për bonjakët, për të varfërit, për kurbetçinjtë. E çdo të mirë që punoni, s'ka dyshim se All-llahu e di"*

(Bekare 215)





gjithpërfshirës. Ky nocion përfshin edhe anën e juridike të fesë ndaj gjërave që jepen Farz dhe Nafile por edhe mirësitë e dhuruara prej All-llahut si malli dhe dituria. Me të vërtetë në këtë ajet nocioni Infak sqarohet në një mënyrë gjithpërfshirëse. “Të cilët e besojnë të fshehtë, e kryejnë faljen (namazin) dhe prej asaj që Ne u kemi dhënë, ata japin (zekat, sadaka etj.)” (Bekare 3)

Ndërsa në ajetin 215 të kaptinës El-Bekare : “Të pyesin se ç’do të japin. Thuaj: “Atë që jepni prej pasurisë jepni për prindërit, jepni për të afërmit, për bonjakët, për të varfërit, për kurbetçinjtë. E çdo të mirë që punoni, s’ka dyshim se All-llahu e di”. Pra do të thotë që kujdesi ndaj gjyshërve dhe baballarve është detyra jonë parësore. Të afërmit e tjerë vijnë pas tyre. Infaku (dhurimi) që u bëhet të parëve është vaxhip (detyrim) ndërsa të tjerëve nafile (vullnetar). Përsëri në kaptinën El-Bekare, në ajetin 219: “...Të pyesin ty edhe se ç’do të japin. Thuaj: “Tepricën”...!” pra jepni tepricën e mallit që mbetet. Duke fituar në rrugë të ndershme kërkoni rizkun për vete, familjen dhe fëmijët tuaj. Tepricën harxhojeni në rrugë të hajrit”

Burrat e zemrës (mutesavvu-fët) e kanë përkufizuar Infakun në tre gradë duke i quajtur “sehavet, xhud dhe isar”.

“Sehavet”, do të thotë që një pjesë të mallit ta japësh dhe një pjesë ta mbash për vete. Resulull-llahu (s.a.s) poseduesin e virtytit të sehavitit (bujarisë) e ka lavdëruar me këto fjalë: “Sahiu (bujari) është afër All-llahut, afër popullit, afër xhennetit dhe larg xhehennemit. Kopraci është larg All-llahut, larg

*“O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim...”*

(Bekare 264)



popullit, larg xhennetit dhe afër xhehennemit. Ai që është paditur por sahi (bujar) është më i dashur tek All-llahu se ai që është adhurues por koprac.” (Tirmidhi, Birr, 40; Axhlûnî, I, 450)

“Xhud”, ka kuptimin; shumicën e mallit ta japësh dhe pakicën ta mbash për vete.

Ndërsa “Isar” ka kuptimin; duke qënë në hall dhe vështërsi t’u japësh përparësi të tjerëve ndaj vetes.

Seha është një bujari brenda një kufiri të caktuar. Xhud është bujaria e pakufishme që tregohet ndaj të gjithëve pa bërë ndarje. Për këtë arsye fjala “Xhevad” i atribuohet All-llahut ndërsa fjala “Sahi” nuk mund t’i atribuohet.

Peygamberi Ibrahim (a.s) ishte Halil (miku) i All-llahut. Ai nuk ulej në sofër pa një mysafir. Një herë në shtëpinë e tij erdhi një mexhusi (adhurues zjarri). Kur Ibrahim (a.s) kuptoi që ai njeri ishte mexhusi nuk deshë ta mikpres dhe i tha: “Ti s’e meriton qerasjen dhe mikpritjen time.” Mexhusi u largua pa bërë zë. Ibrahim (a.s) menjëher u kritikua me shpallje. All-llahu Teala tha: “Ej Ibra-

him, a të erdhi rëndë t’i japësh një vakt bukë njeriut të cilin Unë e ushqej prej shtatëdhjet vjetësh...!?” Ibrahim (a.s) menjëher i shkoi pas, e gjeti dhe e mikpriti. Mexhusi e pyeti për arsyen dhe kur e mësoi tha: “Sa Zot i mirë, kritikoi Halilin (mikun) e Vet për armikun e Vet...” dhe u bë mysliman.

Habibi (i dashuri) i All-llahut Muhammed (s.a.s) kur erdhi Ibn Hatim Tai hoqi mbulesën që kishte mbi supet dhe i’a shtroi atij. Pa bërë dallim midis njerëzve i shtroi veshjen e vet një mosbesimtari. Ja pra, këto ishin nga një shembull i “Seha’s dhe Xhud’it” prej Halilit dhe Habibit.

Thelbësorja në Infak (dhurim) është të japësh pa të kërkuar nevojat. Njëherë një shok i një miku të All-llahut erdhi tek ai dhe i kërkoi katërqind dirhem. Pasi i solli dhe ja dha katërqind dirhem shokut të tij u kthye në shtëpi dhe filloi të qajë. Gruaja i tha; “Meqënëse e pate kaq të vështirë t’i japësh ato para, të kishe gjetur një arsye dhe mos ja jepje.” Miku i All-llahut tha; “Unë nuk qaj për atë, qaj për arsye se nuk e kuptova më parë hallin e tij dhe t’ia kisha dhënë ato para pa m’i kërkuar shoku im”.

Ebu Sehl Su'luki, nuk i jepte askujt me dorën e vetë asgjë. Atë që donte të jepte e linte përdhe. Ndërsa nevojitari e merrte prej aty. Ky botëkuptim bëri që brenda një kohe të lindi edhe zakoni i vënies së "gurit të sadakasë" në oborret e xhamive dhe në krye të rrugëve.

Ky zakon i ka dhënë njeriut dhe nderit të tij një vlerë të madhe por në të njëjtën kohë ishte edhe simboli i besimit ndaj njeriut. Sepse All-llahu me ajetin "O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim..." (Bekare 264) ka për qëllim të mbrojë nderin njerëzor. Përveç kësaj, nevojtarët nuk merrnin prej aty (gurit të sadakasë) ç'të gjenin por merrnin vetëm aq sa kishin nevojë. Kështu që ata njerëz që ishin të nevojshëm por që për arsye të turpfit dhe nderit nuk kërkonin (shih. Bekare 273) kishin mundësi të merrnin atë që kishin nevojë.

Ai që merr nuk ndiente poshtërim prej dorës dhënëse. Dhe ai që jep beson se sadakanë i'a jep All-llahut pa e futur nevojtarin në këto shqetësime. Sepse All-llahu Teala urdhëron: "...All-llahu është ai që pranon pendimin e robërve të vet, pranon lëmoshat..." (Teube, 9/104). Gjithashtu dhe Pejgamberi thotë; "Sadakaja bie në dorën Allahut pa rënë ende në dorën e marrësit"

"All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhennet..." (Teube 111). Në këtë ajet shprehet se shpirti dhe pasuria duhet të jepet në rrugë të All-llahut. Me xhihad jepet shpirti ndërsa me infak jepet pa-

suria. Edhe kjo i ka tre grada:

1. Ata që japin të gjithë pasurinë pa pritur që t'u bëhet borxh zekati.

2. Ata që s'e japin të gjithë pasurinë por që edhe nuk kufizohen vetëm me dhënien e zekatit. Këta përveç zekatit një pjesë të madhe të pasurisë e harxhojnë në rrugë të mirësisë. Në këto vargje të Kur'anit... "... pasurinë që e do ua jep të afërmeve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve..." (Bekare 177) "Dhe jepni nga ajo që Ne u kemi dhënë juve..." (Munafikun 10) kemi provën për këtë.

3. Ata që japin vetëm zekatin, as më shumë as më pak. Kjo është grada më e ulët e Infakut.

Zekat është të çosh në vënd falenderimin për çdo lloj të mire. Shëndeti është një e mirë e madhe. Për çdo organ ka zekat. Për këtë arsye njeriu me të gjitha këto organe duhet të shërbej në të mirë, të kryej adhurimet dhe të mos anoj nga lojrat boshe dhe argëtimi. Nga ana tjetër zekati është e drejta që i ka siguruar All-llahu të varfërve prej mallit të të pasurve. Kush i jep zekatin atij që e ka hak, fiton edhe kënaqësinë e Hakkut (All-llahut) por edhe shpëton prej shqetësimit të llogarisë dhe ndëshkimit.

Qëllimi i zekatit është të shpëtojë njeriun nga një ves i keq si kopracia. Një një hadith thuhet: "Tre gjëra të çojnë në shkatërrim; Kopracia e tepërt, ndjekja e epshit dhe pëlqimi i vetvetes". Ndërsa në një varg

Kur'anor thuhet: "...Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar". (Hashr 9)

Të shpëtosh prej kopracisë është e mundur me bërjen zakon dhënien e pasurisë. Që të zvogëlosh dashurinë ndaj një gjëje arrihet duke u ndarë nga ajo gjë. Në këtë kuptim, zekat do të thotë pastrim. Sepse ai e pastron të zotin nga papastërtia e kopracisë. Pastrimi që bën zekati është po aq sa kënaqësia që ndjen rob kur bën infak (dhurim) në rrugë të All-llahut.

Adhurimi ekonomik është falenderimi i mirësisë së pasurisë. Nëse një njeri i pasur shikon dikë që ka rënë ngusht ekonomikisht dhe nuk jep një të dyzetën nga pasuria që i ka dhënë All-llahu si mund të quhet burrë?

Njërin prej miqve të All-llahut Shibli, e pyesin;

-Sa është sasia që duhet të jepet prej zekatit? Shibli përgjigjet kështu:

- Për dyqind dirhem pesë dirhem. Pra një të dyzetën e mallit. Por kjo është sasia e caktuar prej medhhebeve të Fikhut. Sipas mënyrës së rrugës ku bëj pjesë edhe unë, të japësh të gjith mallin dhe të shpëtosh prej preokupimit të zekatit. Njeriu pyeti prap:

-Cili është Imami (prijësi) yt në këtë çështje? Shibli :

-Ebu Bekir Siddik, tha. Sepse ai dha në rrugë të All-llahut gjithçka kishte dhe kur u pyet: "Çfarë i le familjes?" ai u përgjigj: "All-llahun dhe të dërguarin e Tij"

Sipas një transmetimi thuhet se Aliut (r.a) i takon një poezi e tillë:

Mua nuk më është bërë kurrë zekati farz për arsye të mallit tim.

A i bëhet zekati farz një njeriu bujar?

Njëri prej sufive çdo vit u ndan dervishëve të varfër njëmijë dirhem dhe pas kësaj u thoshte gjithmonë duke u betuar: "Nuk ju kam dhënë as edhe një dirhem zekat". Kjo sepse ky njeri pa pritur të mbushej një vit e ndante mallin e tij dhe për këtë zekati asnjëherë nuk i bëhej farz. All-llahu Teala urdhëron që të paralajmërohen me një ndëshkim të hidhur ata që mbledhin dhe stivosin arin dhe argjendin dhe nuk bëjnë infak (dhurim) në rrugë të All-llahut. (shih - Teube 34)

Kufinjt e infakut janë shumë të gjërë. Në disa hadithe thuhet kështu:

"Të shkosh mirë me njerëzit është sadaka. Të buzëqeshësh kur takohesh me vëllain tënd besimtar është sadaka. Edhe të mbushësh enën e vëllait tënd nga ajo që ka në enën tënde është sadaka." (Muslim Birr, 144)

"Të ushqesh, të përhapësh selamin dhe të thuash fjalë të bukura është sebeb për falje." (Mevsua, IX, 444)

"Ushqeje atë që do për hir të All-llahut." (prej Ibnu'l-Mubarek)

Ashabët (shokët e Profetit) e shikonin si gabim të ulyshin në sofër pa mysafir. Sipas një



*Ebu Sehl Su'luki, nuk i jepte askujt me dorën e vetë asgjë. Atë që donte të jepte e linte përdhe. Ndërsa nevojttari e merrte prej aty. Ky botëkuptim bëri që brenda një kohe të lindi edhe zakoni i vënies së "gurit të sadakasë" në oborret e xhamive dhe në krye të rrugëve.*



transmetimi të Ibn Abbasit për të lehtësuar këtë konceptim të Ashabëve zbriti ajeti: "Mund të hani bashkërisht ose veçmas, nuk është mëkat..." (Nûr 61)

Ata që e panë Aliun (r.a) duke qarë e pyetën dhe morën këtë përgjigje: "Ka shtatë ditë që në shtëpinë time nuk vjen një mysafir. Kam frikë se mos All-llahu Teala më ka ulur në gradë."

Enes bin Malik thoshte: "Zekati i shtëpisë është të caktosh një dhomë të veçantë për mysafirin."

"A ke arritur të dëgjosh ti për rrëfimin e mysafirëve të ndershëm të Ibrahimit?" (Dharijat 24) ky ajet shpreh "përkujdesjen e madhe që tregoi Ibrahim (a.s) ndaj mysafirëve".

Një prej miqve të All-llahut Ibrahim b. Xhunejd thotë: "Njeriu, çfarëdo qoftë, kryetar apo komandant duhet që patjetër të mos u largohet këtyre tre gjërave: të ngrihet në këmbë kur hyn babai i vet në një mbledhje, t'i bëjë personalisht shërbim mysafirrit dhe mësuesit të tij, të pyesi dhe të mësoj atë që nuk di.

"Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë me besim (as kënaqësinë e lumtur në xhennet) derisa të mos e jepni më të dhembshmen (më të dashurën) e pasurisë suaj..." (Al-i Imran 92) ky ajet dhe të gjithë transmetimet e mësipërme që tregojnë për mikpritjen kanë nxjerrë në dritë civilizimin e infakut (dhurimit). Dhomat e posaçme që bëhen për të pritur mysafirët nëpër shtëpi, karvan-sarajat që janë ndërtuar përgjatë rrugëve, hapja e vëndeve për të ushqyer të gjithë, dhomat e fshatit nëpër fshatra dhe vakëfet e formuara për të vazhduar shërbimin në këto vënde tregojnë për ndjesinë e infakut. Të shkëpusësh dhe të japësh prej asaj më të dashurës. Edhe sot nëpër shtëpitë tona kemi dhoma për mysafirët por prej mobiljeve dhe plaçkave të shumta nuk ngelet vënd për mikun. Sadoqë shtëpitë fizikisht zgjerohen nëse ngushtohen zemrat, nuk mund të gjehet vënd për mysafirin.



# I PASURI dhe I VARFËRI në shoqërinë ISLAME

**C**do shoqëri ka të pasur dhe të varfër, domethënë njerëz me të ardhura të ndryshme. Kjo gjendje është që nga krijimi

i kësaj bote. Nga një aspekt kjo është në lidhje me dimensionin e kaderit. Marrëdhëniet ndërmjet të pasurve dhe të varfërve ndryshojnë sipas shoqërive. Ajo fushë është në lidhje me atë që kanë nxjerrë në pah masat fetaro-etike ose metodat filozofike, domethënë është në lidhje me këndvështrimin ndaj njeriut. Të fitoshë pasuri dhe ta shpenzoshë atë, është brenda marrëdhënieve të njeriut dhe në çdo marrëdhënie një masë del në pah. Masat vendosin një model njerëzor...

Një sistem filozofik jetën vazhdimisht e shikon si një fushë lufte, njeriun e llogarit si ujku i njeriut, nga luftërat shkatërruese nxjerr klasa që ndërmjet tyre ka humnera. Një sistem tjetër filozofik luftën ndërmjet këtyre klasave e shikon të domosdoshme. Jeta dhe historia rrjedhin me këto luftëra dhe kur luftërat ndaloj-

në në një kohë fiktive, nxjerr një rregull abstrakt shoqëror ndërkohë që njerëzit janë zhveshur nga pasuria dhe pronat e tyre... Barazimet shoqërore kapitaliste dhe komuniste janë kornizë e asaj që ka nxjerrë në pak ky shpjegim... Siç ka thënë edhe Marks, nëse kulmi i punës nuk ka arritur në shoqëri komuniste, dalin apostopujt e mënyrës kapitaliste dhe thonë se njerëzia është e detyruar ndaj rregjimit kapitalist... Si rezultat i këtij sistemi në Afrikë dalin njerëz që janë fyt më fyt me AIDS ose me mizat, në anën tjetër Firmat ndërkombëtare që gëlltisnin (që kanë një kapacitet aq sa mund të administrojnë) vendet më të fuqishme. Në vendet më të pasura (më kapitaliste) njerëzit e pasurë jetojnë në një rrugë me ata që janë miljarderë do-llarësh.

Ndërsa te ne të pasurit dhe ata që mbledhin domate të kal-

*Islami nuk e mban larg lidhjen e njerëzve me pasurinë... Por ka për qëllim që të sigurojë një pozicion për të pasurit dhe të varfërit e tij.*

bura në orët e mbrëmjes nga vendet e pazarit qëndrojnë larg njëri-tjetrit vetëm sa fqinjët e së njëjtës rrugë.

Nga kjo lind një potencial konflikti si frika e shpërthimit shoqëror apo kundërshtim i globalizimit.

Në të vërtetë në çdo përfundim ka një model njerëzor... Çdo sistem ballafaqohet me produktet e modelit njerëzor që ka favorizuar. Në sistemin kapitalist i pasuri dhe i varfëri, nga një aspekt, bëhen konkretizim në jetën sociale të mënyrës së sistemit **“seleksioni natyror- zgjedhje natyrore, seleksion”** që **Darvini** dhe **Lamarci** kanë pohuar se ekziston në jetën e zakonshme dhe i cili ngre lart të fortin dhe e shkatërron të dobëtin... Të pasurit i ligjërohet identiteti poshtëruës, ndërsa i varfëri ngel poshtë dhe shkatërrohet...

Nëse të dobëtin, të pafuqishmin dhe të varfërin është e mundur ta përkufizojmë me shprehjen **“Tjetri”**, atëherë



***“Tjetri” është njëri prej gurëve të ndërtesës së të njëjtës shoqëri dhe brenda kësaj ndërtese të gjithë janë të lidhur ndaj njëri-tjetrit me ndjenjën e përgjegjësisë në një kornizë të përcaktuar me masat hyjnore.***



i forti dhe i pasuri nuk kanë ndonjë përgjegjësi ndërgjegjshmie kundrejt atij **“Tjetrit”**, sepse ndërgjegjja nuk është një term i ideologjisë kapitaliste por është një term i religjioneve.

Edhe Islami ndërton një shoqëri. Edhe në shoqërinë që ndërton ai ka të pasur dhe të varfër. Islami nuk e mban larg lidhjen e njerëzve me pasurinë... Por ka për qëllim që të sigurojë një pozicion për të pasurit dhe të varfërit e tij. **“I pasuri i shoqërisë Islame”** dhe **“I varfëri i shoqërisë Islame”**

në një atmosferë të ndryshme etiko-shpirtërore zhvillojnë një **“Marrëdhënie paqeje, sigurie madje dashurie”** që i përket shoqërisë Islame. **“Tjetri”** është njëri prej gurëve të ndërtesës së të njëjtës shoqëri dhe brenda kësaj ndërtese të gjithë janë të lidhur ndaj njëri-tjetrit me ndjenjën e përgjegjësisë në një kornizë të përcaktuar me masat hyjnore.

Kur shikojmë të pasurin e shoqërisë Islame, në indet e personalitetit të tij vërehet një ndërtim qelizor i tillë:



-Një njeri i cili nuk harron se çdo mundësi që e fiton, është një taksë e Allahut edhe pse ka dhënë çdo lloj mundimi, se i është dhënë amanet dhe se mbart një cilësi sprovimi...

-Një njeri i cili në këtë aspekt ndjenjën e pasurisë gjithmonë nuk e shikon si "rezervë" dhe pasurinë si mjet për të suaduar...

-Një njeri i cili është i kujdesshëm që kur të çojë mollë në shtëpi ato të mos shikohen nga të tjerët dhe i cili në mendjen e tij ka termin "haku i syrit"...

-Një njeri i cili shqetësohet nga dëgjimi i erës së bukës... Domethënë një njeri i ndjeshëm ndaj "hakut të hundës"...

-Një njeri i cili mendon se edhe i varfëri ka pjesë në pasurinë e tij... Domethënë një njeri i cili punon pak edhe për

të varfërit, një njeri i cili është i pasur për të plotësuar edhe njërin nga kushtet e Islamit si lëmosha ndaj të varfërve, një njeri i cili beson se ka bërë një mëkat njerëzor kur nuk e arrin të varfërin, një njeri i cili e di se do të shkojë në botën tjetër si borxhli, i papastër dhe me një pasuri që nuk do t'i japë dot llogarinë kur nuk e nxjerr hakun e të varfërve...

-Një njeri i cili e shikon lëmoshën si një mjet i kushtit të afërimit për te Allahu...

-Një njeri i cili i vendos në kornizën e të drejtavë vëllazërore të gjitha lidhjet me shoqërinë... Një njeri i cili tjetrin e njuh si vëlla... Një njeri i cili në këtë kuptim e ndjen në trup dhe në shpirtin e tij çdo dhimbje shpirtërore dhe fizike që përjeton vëllai i tij... Domethënë një njeri i cili e përjeton në zemrën e tij urinë, papunësinë dhe brengën e pamundësisë për t'i marrë një dhuratë fëmijës... Një njeri i cili gjithmonë vepron me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj shoqërisë...

-Një njeri i cili e vlerëson si një investim të përhershëm ndihmën ndaj një njeriu në vështirësi...

-Një njeri i cili e pastron zemrën nga pasioni i pasurisë... Një njeri i cili është shumë i kujdesshëm që të mos vendosë pasurinë në zemrën e tij e cila është vendi ku shikon Zoti...

-Një njeri i cili ka një masë etike në fitimin e pasurisë... Një njeri i cili mbrohet nga harami ashtu siç mbrohet nga zjarri... Një njeri i cili nuk e shikon të mundshme çdo mënyrë

për të fituar pasuri... Një njeri i cili e refuzon gënjeshtren, hilen, dredhinë dhe vjedhjen... Një njeri i cili nuk e kthen në pasuri të tij nevojën, dhe vësh-tirësinë e njerëzve...

-Një njeri i cili gjithmonë jeton i shqetësuar nga pamundësia për të dhënë provimin e pasurisë dhe i cili brengoset nga perceptimi si një forcë e vërtetë forcën që jep pasuria...


-Një njeri i cili shpenzimin e tepërt e shikon si një mangësi personaliteti të një njeriu që nuk e ka perceptuar kuptimin e mirësive të Zotit dhe i cili i shpërdoron ato...

-Një njeri i cili bujarinë e kupton si hyrje në fushën e lavdërimit të Zotit...

-Një njeri i cili, kur jep, është i kujdesshëm që të mos lëndojë, që të mos sjellë më vonë ndonjë vuajtje dhe që të mos dëmtojë ndërgjegjen e vëllait të tij. Madje, kur të japë, është i kujdesshëm dhe i përpiktë sikur po e jep në dorën e Zotit... Një njeri i cili e di se do të jetë i privuar nga virtyti i të dhënurit kur të lëndojë, madje një njeri i cili e di se do t'i refuzohet lëmosha... Një njeri i cili, kur të lëndojë, mbart frikën se mos ka lënduar Zotin...

-Një njeri i cili, nëse në vendin ku jeton vdes një njeri nga uria, brengoset nga shqetësimi se nga ajo vdekje do t'i bie një pjesë edhe atij...

-Madje një njeri i cili ka frikë të bëhet i pasur për shkak se e di se çfarë peshe sprovimi sjellë pasuria dhe mos dhënia e saj... Një njeri i cili e jep edhe kursimin më të vogël për shkak se



ndonjëherë një pasuri që e ka mbartur për të nesërmen nuk e ka harmonizuar me tevekkulin ndaj Allahut...

Mirë, po në shoqërinë Islame si është gjendja shpirtërore e të varfërit?

-Islami i cili që në fillim e ka përhapur dhënien e pasurisë dhe lëmoshën në një fushë të gjërë aq sa buzëqeshja, mund të thuhet se asnjë mysliman nuk e shikon në statutin e varfërisë. Sikur një njeri i cili ka vetëm një hurmë apo të gjithë myslimanët që në buzët e tyre mund të shfaqin buzëqeshje, janë brenda statusit të pasurisë. Kështu që në shoqërinë Islame varfëria kurrë nuk është një brengë shpirtërore... I varfëri është një njeri i cili nuk e humb ndërgegjen e tij edhe pse është në gjendje të dobët nga aspekti ekonomik. Në shoqërinë Islame ka një dimension pasurie ku secili mund të japë lëmoshë.

-Një njeri i cili është i sigurtë se qenia Rezzaku'l-Alem e di



*-Një njeri i cili ka një masë etike në fitimin e pasurisë... Një njeri i cili mbrohet nga harami ashtu siç mbrohet nga zjarri... Një njeri i cili nuk e shikon të mundshme çdo mënyrë për të fituar pasuri... Një njeri i cili e refuzon gënjeshtren, hilen, dredhinë dhe vjedhjen... Një njeri i cili nuk e kthen në pasuri të tij nevojën, dhe vështirësinë e njerëzve...*



gjendjen e tij dhe i cili është i lidhur me tevekkulin e një fuqie që i siguron riskun e tij gjatë gjithë jetës.

-Një njeri i cili edhe varfërinë edhe pasurinë e shikon si një fushë sprovimi...

-Një njeri i cili duron...

-Një njeri i cili kanaatin<sup>1</sup> e pranon si një pasuri e pashterueshme.

-Një njeri i cili e shikon si një


mënyrë karakteri Istignanë, domethënë mosshfaqjen e nevojës.

-Një njeri i cili nuk e harron se ka një pejgamber i cili nganjëherë lidhte në bark një gurë për shkak të urisë.

-Një njeri i cili nuk e lakmon mirësinë që i është dhënë dikujt tjetër. Një njeri i cili nuk dëshiron t'i humbasë tjetrit diçka që nuk e ka vetë.

Përktheu: Fatmir SULAJ

1. Mjaftimi me hallallin dhe mospranimi i haramit. Kënaqja me kismetin edhe nëse është pak.





# Thirja për lëmoshë dhe vullneti hyjnor

**K**ur njerëzit u thirrën për të ndarë me homologët e tyre që janë në nevojë ndonjë hise nga pasuria që u ka dhënë Allahu, dhe që t'i shpenzojnë ato për ata, jobesimtarët e refuzuan këtë. Kundërshtuan duke thënë: "Ata që kërkojnë ndihmë janë njerëz që do ta kishin ngopur barkun e tyre po të donte Allahu. Dhe gjëndja e tyre në nevojë s'është veçse një nga shenjat e këtij vullneti hyjnor kundrejt tyre. Sepse po të donte Allahu, pa dyshim që do t'i ushqente dhe do t'u plotësonte nevojat. Krahas një

*grupi njerëzish të ushqyer mirë dhe me nevoja të plotësuara, një grup tjetër njerëzish të skamur nga kjo gjëndje është vetëm një rezultat i vullnetit hyjnor. Është Allahu që dëshiron dhe vendos kështu. Ju, me kërkesën tuaj që të shpenzojmë për ata që janë në këtë gjëndje, po kërkonin nga ne të ndryshojmë një gjëndje që s'e ka përcaktuar Allahu, po kërkonin të çojmë në vend një gjë që s'e dëshiron Ai dhe po na ftoni në një punë që është kundër vullnetit të Allahut. Kështu që kjo nuk është gjë tjetër veçse një shthurrije."*

Në suretu **Jasin** ajeti 47, që tregon për gabueshmërin dhe pavlefshmërin e këtij lloji të mendimit që bëhet shkak për kufër (mohim) thuhet: "**Dhe kur u thuhej: "Jepni nga ajo që All-llahu u begatoi, ata që nuk besuan besimtarëve u thanë: "A ta ushqejmë atë, që sikur të donte All-llahu do ta ushqente? Ju nuk jeni tjetër vetëm se të humbur qartë!"** Kjo sure, madje ky ajet që bën pjesë në të, duke iu referuar fjalevë të mohuesve, shkaqeve dhe llojeve të mendimit që kundërshtojnë

thirrjen hyjnore, u përgjigjet me metodën Kur'anore dhe i hedh poshtë duke i shfuqizuar ato plotësisht.

Mendimi që mbështet në largimin nga ndonjë mirësi që bëhet vetëm për hir të Allahut, siç është infaku (lëmosha), është një mendim i gabuar sipërfaqësor që nuk mbështetet në asnjë bazë të drejtë dhe të vlefshme, është një mashtrim logjik dhe një lojë e vërtetë fjalësh. Ndërkohë që, në jetën e kësaj bote çdo gjë është nën ndikimin e zhvillimit dhe të ndryshimit të vazhdueshëm; të mohosh bollëkun dhe moskamjen, të gjykosësh ngjarjet që ndodhin para syve; të mohosh ndryshimet që përjetojmë vetë me përvojë në jetë, pandryshueshmërinë e vullnetit hyjnor për njerëzit, në kuptimin definitiv, dhe të mbrosh ligjin hyjnor të vlefshëm për çdo rrethanë, nuk është gjë tjetër veçse rezultat i mosinteresimit. Me sa duket, kjo buron nga moskuptimi i përmbajtjes së vullnetit hyjnor, ose më drejtë nga keqkuptimi i saj dhe ndoshta nga krahasimi i saj, duke e reduktuar dhe e përngjasuar atë me konceptin e dëshirave dhe të kërkesave njerëzore.

Megjithatë, faktori i jetës është diçka ndryshe nga fati që e përcakton atë dhe nga vullneti hyjnor. Për robët e të zotët të mendjes, ligji definitiv në fjalë është gjithashtu diçka tjetër nga pëlqimi ose zemërimi hyjnor që formon bazën e saj.

P.sh.: gjendja e njeriut në varfëri, kalimi i tij në bollëk dhe më në fund, të gjitha gjendjet që përjeton ai gjatë bollëkut, janë situata të ndryshme që gjithnjë realizohen në kuadër të vullnetit hyjnor. Për secilën nga

këto gjendje dhe faza, ka një vartësi të vullnetit hyjnor dhe për çdo moment të jetës shfaqet një vendim i veçantë. Nga kjo pikëpamje largpamëse, madje që nga momenti që sapo kemi perceptuar, nuk mund ta imagjinojmë dhe ta përmendim vullnetin hyjnor. D.m.th. në këtë kontest, në të vërtetë, nuk jemi të zotët të komentojmë vullnetin hyjnor se si është në këtë apo atë çështje. Faktikisht, procesi i kësaj bote është tërësisht i përbërë nga një faktor sprovues dhe brenda këtij kuptimi ndodhin ndryshime të vazhdueshme. Vullneti hyjnor që përbën këtë faktor, siç u jep mundësinë e zhvillimit dhe të ndryshimit për gjëra të ndryshme e të kundërta me njëra-tjetrën dhe është i hapur për këto, lejon edhe realizimin e veprave të njeriut - për çdo njeri një vijë të veçantë - . Vullneti hyjnor në këtë proces, ngaqë në kuptim përputhet me urtësinë e krijimit të jetës së kësaj bote, absolutisht dhe definitivisht, nuk pasqyron pëlqimin dhe ligjin hyjnor dhe nuk përfaqëson rezultatet e përhershme.

Në këtë kontest, moskamja e të varfërit, ngaqë nuk është një statutë e vazhdueshme, e përhershme dhe e pandryshueshme për të, gjithashtu edhe gjendja e të pasurit dhe e atij që është në bollëk është kështu. Është e ditur se varfëria dhe pasuria, krahas të qenurit një nocion sprovues për njerëzit, ajo shpesh ndryshon pozicion.

*"Dhe kur u thuhej:  
"Jepni nga ajo që All-llahu  
u begatoi, ata që nuk besuan  
besimtarëve u thanë: "A ta  
ushqejmë atë, që sikur të donte  
All-llahu do ta ushqente? Ju  
nuk jeni tjetër vetëm se të  
humbur qartë!"*

Është e qartë se pasuria nuk është një veçori e vazhdueshme, ndërsa edhe varfëria nuk është një humbje e përhershme. Duke parë këtë gjendje të përkohëshme dhe të ndryshueshme, askush nuk duhet të pretendojë kurrë se është i privilegjuar ose i larguar nga Allahu.

Mohuesit, ndoshta ngaqë paragjykojnë kështu, pretendojnë se ka ndarje klasash midis tyre e atyre që janë në nevojë dhe kështu që kanë rënë në një gabim të hidhur (fatal). Saqë me këtë gabim, u janë prishur strukturat sensitive, e më në fund kanë humbur aftësitë të kuptojnë dhe të dallojnë një vepër të mirë, siç është shpenzimi për të varfërit. Me pretekstet dhe me fjalët e tyre që kamuflojnë kopracinë e tyre, janë larguar shumë nga realiteti.

Allahu i Madhëruar, ndonjëherë dëshiron që vullneti dhe dëshira e Tij të realizohet edhe me dorën e njeriut. (Frazë: "Allahu i ndëshkoi dhe i poshtëroftë ata me duart tuaja." e ajetit 124 të suretut-Teube, është një nga shembujt që argumenton këtë gjë.) Ai,

kur dëshiron ndonjë të mirë për dikë, padyshim që është i aftë ta realizojë atë ashtu siç ka dëshiruar (në çdo lloj mënyre). Por, ndonjëherë dëshiron që kjo të realizohet direkt nga dora e tyre, duke përdorur një metodë të veçantë kontakti e komunikimi midis njerëzve dhe kështu që, ata i bën ndërmjetës dhe nëpunës të kësaj mirësie e mëshire. Dëshiron që ata të marrin pjesë në bamirësi, duke iu drejtuar e iu referuar asaj dhe të përfitojnë duke marrë pjesë nga ajo. Dëshiron që besimi i robëve të Tij, me këtë mirësi të madhe, të forcohet konkretisht e ta nxjerrin në pah atë, dhe me këtë të fitojnë fisnikëri. Kështu që, siç ndodh edhe me shembullin e sadakasë, si dhënësin ashtu edhe marrësin, i afron më afër marrëdhënieve të ngrohta në lidhje vëllazërore, forcon solidaritetin social dhe krijon mirësi e bukuri pallogari që nuk

i magjinojmë dot. Në urdhrat e Tij, padyshim që ka urtësi të mëdha, të cilat ne nuk i përfshijmë dot (së konceptuari).

Nga ana tjetër, ngaqë për njeriun pasuria dhe varfëria në jetën e kësaj bote përbëjnë një sprovë, më me rëndësi është se si do t'i përballojë ai këto situata. Që të dyja situatat, e ngarkojnë njeriun me disa detyra dhe përgjegjësi. I pasuri, homologun e tij të varfër që ka përballë duhet ta konsiderojë si një mundësi për veten e tij, që i serviret për ta ftuar atë të përfitojë nga kjo mirësi. Sepse thyerja e ngulitjes së gabuar të mendimit për pasuri dhe jetë të kësaj bote, mposhtja e kopracisë dhe e tamahut (mosngopjes), mund të arrihet vetëm në këtë mënyrë. Kjo është mundësia më e mirë për atë, që të vlerësojë e të shpenzojë pasurinë e tij për hir të Allahut. Allahu i Madhë-

ruar, duke i nxjerrë përballë të varfërin, i flet atij drejtpërdrejt, me gjuhën e rrethanave. Nevoja e të varfërit për të, është një mundësi pastruese (të pasurisë së tij) dhe një mjet që e fton atë në bamirësi. Në këtë pikëpamje, kjo është punë e vërtetë. Ndërsa, i varfëri duhet të durojë dhe nevojat e tij duhet t'ia parashtrijë vetëm Allahut, pa prishur besimin, mbështetjen e fisnikërinë; dhe të gjitha mirësitë duhet t'i dijë se vijnë vetëm nga Ai.

Lëreni homologun, për njeriun, ka edhe një thirrje tjetër për vepra të mira në kafshët që ka nën kujdestarinë e vet. A është gjë e vogël që, duke tundur bishtin dhe shfaqur sjellje tërheqëse e të ngrohta, macja dhe qeni të kërkojnë nga njeriu? Allahu i Madhëruar i ka bërë edhe ata një mjet mirësie dhe mëshire për njerëzit. Ai, me metodat e Tij, duke krijuar shkaqe të lehta e të thjeshta, robit të Tij i ka hapur të gjithë të ardhmen e tij, i ka dhuruar atij çdo gjë që ia lehtëson ecurinë drejt lumturisë dhe që e afron atë më tepër te ajo. I gjithë problemi qëndron te fakti se duhet ta shikojmë këtë dhe të dëgjojmë thirrjen hyjnore.

Në çdo thirrje që të fton në të mirë - madje po të jetë edhe ndonjë kafshë që të ndërmjetësojë te ajo - ka një kuptim që e lidh njeriun. Çdo kërkesë për vepra të mira që i drejtohet atij, e obligon automatikisht njeriun. Njeriu që i drejtohet kësaj, duhet t'i përgjigjet menjëherë dhe duhet të bëjë ndonjë gjë për veprën e mirë për të cilën është i ftuar. Sepse çdo ndodhi që përballlet me të, i jep njeriut mundësinë të mendojë e të vlerësojë përsë-



ri pozitën e tij dhe gjendjen që ndodhet. Ndërsa, nëse kërkohet nga ne ndonjë vepër e mirë (realiteti që kërkojmë gjithmonë), d.m.th. ekzistenca e dëshirave tona pafund që ia drejtojmë Zotit, duhet të na kujtojë e të na bëjë të mendojmë se nuk kemi asnjë dallim nga lypësi që kemi përballë. Në momentin që kujtojmë këtë gjë, duke menduar gjendjen tonë thelbësore, ndiejmë se jemi të varur nga lutja që na drejtohet personalisht. Sepse ajo që shfaqet, në të vërtetë, është një thirrje e Allahut të Madhëruar dhe në esencë kjo është një urdhër hyjnor që na drejtohet neve drejtpërdrejt.

Mënyra e thirrjes që i drejtohet zgjedhjes (preferencës) sonë, mund të jetë për të treguar rëndësinë e madhe që i jepet nevojave njerëzore dhe kontributit me dëshirë. Nga ana tjetër çdo thirrje, në të vërtetë, është një urdhër.

Faktikisht, prandaj është thënë: **“As lypësin mos e përzë!”** (Suretu’*d-Duha*, ajeti 10). Ndërsa kur shpjegohet mënyra e jetës së të devotshmëve në këtë botë, të cilët janë shpërblyer me xhennet, situata e tyre është përmbledhur dhe përshkruar me këto fjale: **“Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por nuk lyp)”**. (Suretu’*dh-Dharijatë*, ajeti 19). Prandaj, përveç atij që njihet se abuzon (duke mashtruar e gënjer), të cilët nuk janë të shumtë aq sa mendohet, asnjë lypsar nuk duhet të kthehet mbrapsht (të refuzohet). Nuk duhet të komentojmë e të vlerësojmë shumë mbi përmbajtjen që na është drejtuar kërkesa (lutja), veçse brenda kufijve të lejuar. Sepse duhet të kujtojmë se nuk do të

na pëlqejë shumë kritika që na bëhet për kërkesat tona, duhet ta marrim veten tonë si kriter dhe, me këtë mendim të hollësishëm, duhet të sillemi tolerantë.



Në të vërtetë, çdo moment i jetës, si një realitet që shfaqet imtësisht, është një sprovë dhe një përvojë që i nënshtrohem të gjithë drejtpërdrejt. Çdo gjë që na drejtohet e që përjetojmë, në radhë të parë, duhet ta vështrojmë nga ky aspekt dhe, me këtë vështrim, duhet t’i japim kuptim.

Njeriut, gjatë gjithë jetës së tij në këtë botë, i kërkohet dhe i lutet nga dikush për disa gjëra. Këto janë kërkesa (lutje), që pak a shumë kërkojnë sakrifica dhe vështirësojnë fitimet individuale. Për unin është një thirrje jokonsekuente (nuk përputhet me arsyen). T’i përgjigjesh kësaj ose të japësh lëmshë pa diskutuar asnjë ftesë, padyshim që për njeriun është një sjellje fisnike, e cila bazohet në besim.

Kur’ani Famëlartë urdhëron lëmshën dhe ata që nuk duan ta pranojnë atë, i refuzon duke i shfuqizuar haptazi kundërshtimet e tyre. Por, jemi dëshmitarë të fjalëve që tregojnë se kundërshtimet e kufrit për këtë çështje dhe mendimet që mbështeten në të, vazhdojnë identikisht edhe sot. Refuzimi duke thënë: **“Zoti të dhashtë”**, që i bëhet atij që i kërkon dikujt, nuk është rast i vetëm që hasim. Personi që arrin ta shqiptojë këtë, vallë,

**Është e qartë se pasuria nuk është një veçori e vazhdueshme, ndërsa edhe varfëria nuk është një humbje e përhershme. Duke parë këtë gjendje të përkohëshme dhe të ndryshueshme, askush nuk duhet të pretendojë kurrë se është i privilegjuar ose i larguar nga Allahu.**

mos mendon se është i përjashtuar dhe i panevojshëm për rrugën e Allahut? Ose pretendon se nuk ka nevojë të marrë pjesë në ndonjë vepër të mirë, duke u bërë shkakhtar për në rrugën e Allahut? Ku e gjen guximin dhe të drejtën për ta refuzuar këtë gjë, kur i kërkohet ndonjë gjë që ka mundësi ta bëjë, duke i nxjerrë pretext Allahut?

Kjo fjali kundërshtuese, nuk ka asnjë dallim nga fjalët mohuese, që ceken në ajetin 47 të suretu’*j-Jasin*, që përmendëm pak më lartë. Faktikisht, siç është edhe për besimin ashtu edhe për mosbesimin, që nga ajo ditë nuk ka ndryshuar shumë gjëra. Prandaj, Kur’anin Famëlartë duhet ta lexojmë në këtë pikëpamje dhe të ndjekim me kujdes shpjegimet që u jep përgjigje thënieve për mosbesimin aktual. Vetëm atëherë, përtej të gjitha imagjinatave, mund të shohim se do të përfitojmë nga udhëzimi i vërtetë, me të cilin shpallja hyjnore na zgjeron horizontin dhe na ndriçon kundrejt mashtrimeve mosbesuese.



# Të dhurosh në rrugën e Allahut



*“Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. All-llahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, Allahu është Bujar i Madh, i di qëllimet.”*



**S**ebilull-llah është një nga idetë që kur’ani i ka dhënë islamit për të formuar një jetë sa më të veçantë dhe qytetare. 1 Sebilull-llah, ka kuptimin rruga e All-llahut. Sepse Rruga e All-llahut, është një nga llojet e mirësive që Ai ia ka dhuruar njeriut me anë të shpalljes të Kuranit. Për këtë arsye sebilullah, përfshin të gjitha mënyrat e zhvillimit të njerëzimit në mirësitë që janë për njerëzimin në jetën e kësaj bote dhe në jetën e botës tjetër. Kurani dhe sunneti, me këtë qëllim i udhëzon njerëzit për të formuar një jetë

sa më të lartë sociale dhe sa më të rregullt. Duke shikuar theksimet që kalojnë nëpër ajetet, ku thonë për infakun në rrugë të All-llahut, për hixhret (shpërngulje) dhe për luftën, ky përcaktim e vërteton thelbin e kësaj. 2 Këtu do të tregojmë vetëm infak’un në rrugë të All-llahut.

## **Çfarë është infaku?**

Fjala infak vjen nga shkronjat n f k nga Arabishtja, e cila ka kuptimin “Të paksuarit, të mbaroj dhe të harxhosh” 3 Për këtë arsye, infak është kur njeriu dhuron dhe shpenzon në

rrugë të All-llahut “pasurinë e tij që është hallall dhe e vlefshme, ose mundësinë e tij që reale”. Ky shpenzim, mund të bëhet në të gjitha gjërat e vlefshme që janë të njeriut. Ata që harxhojnë pasurinë hallall dhe mundimet e tyre pozitive për të mirën e njerëzve, të tillët janë përmendur në Kuranë “Të harxhosh në rrugën e Allahut”. 5 Siç e shikojmë sipas kësaj, nuk ka ndonjë pasojë humbjeje ai i cili harxhon dhe shpenzon për në rrugën e Tij. 6 Kjo do të thotë që, besimtari i cili gjatë jetës së tij mundohet dhe shpenzon

bujarisht në rrugë të All-llahut, nuk do të shkojë bosh në ditën e llogarisë (kijametit).

### **Ku dhe si duhet të bëhet infaku?**

Përgjigjen më të saktë dhe më të mjaftueshme përsëri Kurani na e jep. Fjala infak vjen nga shkronjat nfk dhe në Kuran është përdorur rreth shtatëdhjetë herë. 7 Në këto ajete, kërkohet që infaku të bëhet nga gjërat më të mira dhe më të dashura. 8 Infak, është një cilësi nga më të qartat e personalitetit të muslimanit. Ai, për hir të All-llahut me mundësitë e tija, mundohet dhe shpenzon me qëllim që edhe të tjerët të përfitojnë nga mundësitë e tij. 9 Bërja e infakut duhet të vazhdojë nga më të afërmit. 10 Në veçanti kjo duhet të bëhet tek ata persona të cilët janë të ndershëm dhe janë të turpshëm në shfaqjen e varfërisë së tyre. 11 Sepse ai që

nuk e dallonë gjendjen e tyre, mendon se ata janë të pasur, porse në realitet ata janë të varfër dhe janë të turpshëm në të kërkuar. 12 Kur të bëjmë infak, nuk duhet ta nënçmojmë personin të cilin e ndihmojmë dhe gjithashtu duhet të qëndrojmë larg nga sysipërfaqësia. Sepse Kurani, synon marrdhëniet e mira ndërmjet njerëzve dhe edukatën islame, gjithashtu ka theksuar se sjelljet që janë në të kundërta me edukatën islame dhe me nderin e njeriut, nuk kanë për t'i sjellë asnjë dobi personit që i vepron. Në veçanti tërheq vërejtjen se syfaqësia nuk do ti sjellë asnjë dobi atij personi. 13 Sa më i sigurtë që të jetë njeriu në infakun e tij, aq më shumë do të jetë shpërblimi që do të marr nga All-llahu i madhëruar. Kështu që infaku, duhet të jetë me një sinqeritet dhe me një sjellje shumë edukative. Qëllimi i fesë me këto synime është, të qenurit e njeriut një robër i mirë i All-llahut, gjithashtu për të qenë një person i cili bën mirësi edhe njerëzve të tjerë. Sepse All-llahu, nuk ka nevojë për infakun dhe adhurimin e askujt. Infaku, është një sjellje nga tev-hidi e cila e shtyn njeriun për në një jetë të suksesshme dhe besimtarin për fitimin e kënaqësisë së All-llahut. Kur'ani gjendjen e tyre që bëjnë infak siç duhet, i përmend duke thënë: "Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë ka-

*Fjala infak vjen nga shkronjat nfk dhe në Kuran është përdorur rreth shtatëdhjetë herë.*

llinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. All-llahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, All-llahu është Bujari i Madh, i di qëllimet." 14

### **Çfarë duhet për infak?**

Për të bërë infak në rrugë të All-llahut, pavarsisht nga sasia e pasurisë që zotëron dhe mundësie materiale, kryesore është që njeriu infakun ta ketë në besimin e tij, në dituri dhe në fuqinë e tij. Sasia e të dhënurit e infakut është sipas mundësisë. Për këtë arsye, ata të cilët janë shfrytëzues të tjerëve, edhe nëse janë zotërues të një pasurie të madhe, përsëri tek ata nuk gjindet guximi për të bërë infak të tjerëve nga kjo pasuri. Pasuria që të jetë e dobishme dhe që ta ngrijë shpirtërisht njeriun, për parimin e mirë të jetës, fillon duke dhuruar në rrugë të All-llahut. Për këtë arsye Islami, ia ka zgjeruar kufijtë e adhurimit me infak. Thënia e Kuranit "bëni infak (jepni) në rrugë të All-llahut", synon të thyej shikimet e mizorëve ndaj njerëzve të varfër, të cilët i nënçmojnë njerëz si të pa vlershëm, gjithashtu synon edhe të para-



ndaloj idhujtarinë e pasurisë të atij që e zotëron atë dhe gjithashtu idhujtarinë e imagjinatës së fukarait për një pasuri të madhe. Për këtë arsye Kurani, atyre të cilëve me anë të pasurisë së tyre do të gjejnë lumturinë dhe kënaqësinë, u përmend se: "All-llahut i mbesin trashëgim qiejt e tokë? Dhe më pas atyre u shtron pyetjen: "E, ç'keni ju që nuk jepni për në rrugën e All-llahut." 15. I kritikon ata të cilët janë të dhënë pas pasurisë së kësaj bote dhe që bëjnë koprraci duke u thënë: "Ja, ju jeni ata që ftohni për të dhënë në rrugën e All-llahut (për luftë kundër armikut tuaj), e dikush prej jush bën koprraci, e kush bën koprraci, ai bën kundër vetvetes, All-llahu s'ka nevojë, e ju jeni të varfër (keni nevojë). Po nëse ju i ktheni shpinën, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju." 16 Ata që nuk e kanë arritur vlerën e besimit dhe diturinë e infakut, bëjnë koprraci ngaqë janë humbur pas të dhënurit në pasuri. Ata nuk interesohen me varfanjakët, nuk bëjnë asnjë harxhim për në mirësi dhe kështu pasurinë e tyre e shpërdorojnë keq. All-llahu nuk u jep rëndësi, atyre të cilëve nuk janë të ndjeshëm ndaj të varfërve. Njeriu ose popujt që All-llahu nuk u jep rëndësi, kanë humbur kënaqësinë e All-llahut dhe lartësimin e tyre. Për këtë arsye kur'ani, gjithmonë normat edukative i ka thurur në jetën sociale për të qenë vazhdimisht në praktikë.

I bën thirrje çdo njeriut për në rrugë të drejtë dhe për në mirësi sipas mundësisë së tij, i thirr për të mundur varfërinë si nga ana shpirtërore ashtu edhe nga ajo financiare. I tërheq vërejtjen atyre që largohen prej kësaj

ndihmeje, duke u thënë të përgatisin rrëzimin e tyre. 17 Nënkuptohej se braktisja e mirësive dhe e infakut, për njeriun është një lloj vetëvrasje për të. Duhet vullnetari për të arritur nivelin më të lartë në besim. Gjithashtu vullnet do të thotë, të japësh për hir të rrugës së All-llahut disa gjëra që nefsi i njeriut i dëshiron për ti fshehur për vehten e tij. Personi dhe gjithashtu populli për të qenë zotëruar të një kartnjoftimit të moralit islam, këtë mund ta arrijë duke jetuar një jetë të nënshtruar dhe të bindur ndaj principeve të Kuranit. Nga kjo nënkuptomë se njeriu për të qenë një besimtarë i mirë, nuk i mjafton vetëm të besojë; por bashkë me besimin e tij në All-llah ai duhet të mundohet me shpirt dhe me pasurinë e tij në rrugë të All-llahut. 18 Sepse shpirti i njeriut, nuk ushqehet vetëm me teoritë reale. Bashkë me këto, njeriu vazhdimisht ka nevojë për bazat e punës e cila e lartësojnë atë. Ja pra, Kurani i është përgjigjur të gjithë nevojave që ka njeriu për çdo lloj teme duke ia treguar atij rrugën e drejtë të saktë në mënyrë të gjerë.

Së fundi mund të thuhet se, po jetojmë në një kohë ku pasuria e kësaj bote dhe dashuria ndaj saj, i ka bërë njerëzit të harrojnë Krijuesin e tyre All-llahun e madhëruar. Shkaku kryesorë i kësaj është, të dhënurit pas dëshirave dhe kënaqësive të kësaj bote, të cilat na mposhtin. Shpresojmë që nga kjo gjendje negative, të dalim me infak dhe me mundimet tona fitues përballë kësaj gjendjeje në një kohë sa më të shkurtër, në këtë kohë në të cilën shpirtat e njerëzve janë ngushtuar.



- Dipnotat:** 1. Shih: Muzzemmil 73/20; A'raf 7/45, 86; En'am 6/116 etj.  
 2. Shih. Bekare 2/190, 195, 218; Enfal 8/74-75 etj.  
 3. Shih. ibn Mandhur Lisanu'l Arab, X, 358-361  
 4. Shih. Ragib el-isfehani, el-Müfredat, fq.819  
 5. Shih. Bekare 2/195, 261, 262 etj.  
 6. Shih. Muzzemmil 73/20 etj.  
 7. Shih. M.FuadAbdulbaki, Muxhemu'l Mu-fehrez, fq.715  
 8. Shih. Bekare 2/267; Al-i Imran 3/92 etj.  
 9. Shih. Bekare 2/274; Al-i Imran 3/134 etj.  
 10. Shih. Bekare 2/215  
 11. Shih. Bekare 2/273  
 12. Shih. Bekare 2/262, 264  
 13. Shih. Maun 107/6-7 etj.  
 14. Bekare 2/261  
 15. Shih. Hadid 57/10  
 16. Muhammed 47/38  
 17. Shih. Bekare 2/195  
 18. Shih. Huxhurat 49/1

## BABA NALLANXHIU: PO SULLTANI Ç'PUNË BËN?

Murat Han (Murati III) atë ditë ishte në formë. Dukej i preokupuar. Thua se kërkonte të thoshte diçka dhe më pas heq dorë. T'i thuash i gëzuar s'ishte, t'i thuash i mërzitur nuk ishte. Sijavush Pasha pyet:

- Zotëri ka diçka që ju shqetëson?

- Mbrëmë pashë një ëndërr të habitshme.

- Të shpresojmë të jetë e hajrit.

- Do ta kuptojmë nëse është e hajrit apo e sherrit.

- Çdo të thotë kjo?

- Përgatitu të dalim jashtë.

Nisen që të dy. Me sa u

kuptua sulltani vazhdonte të ishte nën ndikimin e ëndrrës kështu që e di mirë rrugën se ku do të shkojë. Me hapa të sigurtë shkon në Bejazit. Kthen në zonën Vefa dhe zbret poshtë nga Zejreku. Përreth Unkapës merr frymë thellë. Sheh me kujdes rreth e përçark. Në atë moment vë re një kufomë. Pyesin se kush është dhe i thonë:

- Një i shkretët!

- Ku e di

- Na trego edhe ne ta dimë. Komshiu ynë i katërdhjetë viteve.

Komshitë janë të nevrikosur

Një tjetër hyn më në detaje dhe vazhdon: - A e dini? Në

fakt është një mjeshtër i mirë. Punon në Pazarin e Azapëve, punon nalla, por ato që i fiton i harxhon në pije dhe me gra. Nga njëra anë çon shishe vere në shtëpi nga ana tjetër shkon pas grave të njohura. Njëri nga të moshuarit është shumë i nevrikosur:

- Si të dëshironi pyesni komshitë, thotë – Pyesni njëherë a e ka parë kush në xhemat?

Si përfundim pjestarët e zonës kthehen. Askush nuk mbetet aty. Ndërkohë që edhe veziri po bëhej gati dhe sulltani i pret rrugën.

- Për ku?

- Nuk e di. Ma merr mendja se qëndroni larg këtyre burrave.

- Kështu janë njerëzit, ikin dhe të lënë. Askujt nuk mund ti them gjë. Por ne nuk mund të shkojmë. Në një mënyrë a në tjetrën jemi këtu. Na duhet ta plotësojmë defnin.

- Edhe më mirë, dërgojmë disa hoxhallarë nga saraji dhe shpëtojmë nga detyrimi.

- Nuk mundet. Akoma nuk e kemi gjetur urtësinë e ëndrës.

- Atëherë ç'më urdhëroni të bëj?

- Vazhdoni detyrën e kryegjykatësit. Të paktën kufomën duhet ta heqim.

- Por zotëri si mund ta heqim?

- E ngrejme si zakonisht

- Ju lutem mos e bëni këtë sulltan. Kjo duhet edhe larë, më pas edhe rregulla të tjera, tekfini, telkini.

- Mos u bëj merak, unë e bëj. Por fillimisht duhet të gjejmë një vendlarjeje.

- Këtu ka një mesxhid, por se di...

- Nuk bën. Sikur të ishte ti i vdekuri ku do të doje të merresh?

- Nuk e di nga Ajasofja, nga Sulejmanija. Të paktën nga Xhamia Fatih.

- Në Ajasofja dhe Sulejmanije ka shumë nga pushtetarët. Nuk dëshiroj të njihem. Por xhaminë Fatih e the mirë. Hajde ta marrim dhe të shkojmë.

Dhe vijnë në xhami. Sijavush Pashai vrapon sa majtas sa djathtas për të gjetur qefin dhe arkivol. Padishahu i hedh në oxhak kazanët prej bakri. E lajnë mirë sipas zakonit. Një dritë rrezaton në ball. Fytyra nuk i ngjan hajdutëve. E për më tepër në buzët e tij lexohet një buzëqeshje kuptimplote.

Padishahu ishte ngrohur ndaj këtij burri, po kështu edhe veziri. Nallanxhinë e panjohur e shtrijnë në tabut. Por kishte përsëri kohë për namaz. Një moment veziri afrohet ashtu si i mërziur – Sulltan thotë, Me sa duket po bëjmë gabim.

- Pse?

- Na mbërtheu emocioni, e sollën kufomën pa pyetur, ndoshta mund të ketë ndonjë jetim?

- E drejtë, ashtu është. Ti qëndro këtu sa të pyes unë njerëzit e mahallës.

Veziri qëndron tek vendi ndërkohë padishahu vazhdon aventurën aty ku ishte lënë. Pyet dhe gjen shtëpinë e nallanxhiut. Ne derë del një grua plakë. E dëgjon me vëmendje ngjarjen sikur e kishte pritur një gjë të tillë. – Na e bë hallall biri im, thotë, - Dukesh se je lodhur shumë. Më pas kalon te



pragu, i mbledh duart grusht dhe i mbështet në gjunjë.

Qan? Jo. Ama sytë i përlo-ten, ndoshta futet në mendime. Pse më pas vjen në vete. Fillon të flasë si me vete: - E di biri im? Një botë më vete ishte zotëria. Punonte nalla deri në darkë, por që mos të shihte njeri me shishe vere në dorë ia merrte nga dora dhe e blinte. Më pas e sillte dhe e derdhte në tualet.

- Pse?

- Që mos të pinte bashkësia e Muhamedit.

- Çudi.

A nuk u mora kohën?

Më pas u jepte pagesën grave dhe e sillte në shtëpi. - A nuk ua mora kohën tuaj, ua mora. Thoshte, - Atëherë duhet të dëgjoni... Ai u largonte ndërsa unë tregoja pjesë të ndryshme. Lexoja ilmihalin

dhe historinë Islame.

Shiko shiko! Kurse në fakt ç'pamdehin njerëzit.

- As që më bën përshtypje se çmendon njerëzia. Ai shkon-te përherë në xhamitë më të largëta. Më duhet të qëndroj pas një imami të tillë që... kur merr tekbinin fillestar të shohë qaben.

- Sa imamë kanë mbetur tani

- Ja edhe për këtë arsye që ai zgjatej përtej Nishanxhasë, Sofuve. Madje një ditë thashë: - Shikoni zotëri.

- Ti bën kështu, por njerëzit do të mendojnë për keq, më beso se do të të mbetet xhenazeja në mes të rrugës.

- E drejtë, ashtu është.

- Askush mos të marrë zahmet, tha dhe hapi një gropë në kopësht. Por unë e mora përsipër. A përfundon puna

me varrin? Kush do të të lajë ty, kush do të ta ngrejë xhenazen?

- Mirë po ai ç'tha?

Në fillim qeshi me të madhe, më pas tha: - Allahu është i madh grua. Pastaj për çfarë është sulltani.

### **Turbeja e tij është në Unkapin**

Emri i vërtetë i nallanxhiut është Muhamed Mini Efendi. Është nga Bergama. Vdiq në vitin 1592. Shërbimet e xhenazes së tij i kreu vetë padishahu dhe e varrosi në shtëpinë e tij. Mbi varr i vendosi një kubbe ndërsa përpara një çezme. Me një tekke ia përjetësoi emrin. Turbeja e tij ndodhet në Unkapin, pas fabrikës Xhibali Tutun, përballë xhamisë haraçzade vetë sulltani ndërroi jetë pas tre vitesh. Një Fatihë për shpirtrat e tyre.

# Rimëkëmbja e një shoqërie mbi bazën e sadakasë



*“Kush shpëton një zemër njerëzore ka shpëtuar një shoqëri të tërë”*



Gjatë periudhave të ndryshme historike gjendja ekonomike e një populli, e një vendi ka kaluar në shumë faza duke u bazuar përherë mbi parimet e politikës së kohës. Asnjëherë nuk kanë munguar investimet e shumta nga donatorë të ndryshëm të cilat duhet të pranojmë që kanë qenë të shumta, investime këto që kanë përfshirë aspekte të ndryshme të jetës sociale gjithmonë me qëllime të caktuara. Jemi dëshmitarë gjithashtu të shumë shërbimeve që kryejnë grupe të ndryshme njerëzish të cilët mbi bazën e një sigurie të plotë në besimin e tyre, të bazuar

në vizionin e lartë dhe fisnik të shpjeguar mjaft qartë nga Kurani famëlartë dhe hadithet e Profetit tonë Muhamedit (a.s) janë nisur drejt një rrugëtimi që vetëm fillim kishte (ndoshta disi të vështirë) dhe që njeh vetëm vijëmsië të plotë pa ndalesa dhe me sa duket nuk ka ndër mend të dijë se deri kur do të vazhdojë i tillë. Njerëz të zakonshëm, të jetës së përditshme, mbledhen një ditë prej ditësh dhe në bisedë e sipër shtrojnë përpara vetes një detyrim moral dhe ndërkaq edhe fisnik. Ata vendosin që ashtu të mbledhur të marrin përsipër që të japin diçka nga pasuria e tyre, nga ajo që ato

kanë dhënë jetën e tyre, nga ai fitim që u mundësohet nga munda dhe sakrificat e dhënë. Një vendim ky mjaft human dhe njerëzor njëkohësisht i cili përkrahet nga të gjithë anëtarët e grupit. Ata mund të ishin disa vetë që mund të mos e kalonin numrin 10 të pjesmarrësve dhe ashtu të mbledhur marrin përsipër disa vendime mjaft jetike për kohën, të kontribuojnë me sa kanë mundësi në fushën e jetës, në rimëkëmbjen e vendit. Janë këta njerëz të profesioneve të ndryshme, mjek, inxhinier, mësues, njerëz të artizanatit, tregtarë të vegjël apo të mëdhenj dhe ajo që është më e

veçanta të gjithë këta i ka bashkuar ndjenja e kontributit me një qëllim të caktuar, rimëkëmbjen e vendit. Këta individë në zemrat e tyre kanë vullnetin e mirë që me sa kanë mundësi të jenë pjesë e një zhvillimi dhe integrimi, të jenë pjesë e një ndryshimi që në fund të fundit pse të mos fillojë që aty.

Me një vullnet të papërshkrueshëm, me një dëshirë të zjarrtë që buron nga shpirti fisnik dhe human këta njerëz morën përsipër një rrugëtim mjaft të vëshirë për të përballuar peripeci nga më të ndryshmet. Rruga e tyre do të sihte e gjatë, por aspak e vështirë në një anë, pasi në zemrat e tyre ishte dashuria për Krijuesin e gjithësisë dhe të dërgurin e Tij Muhamedin (a.s), në shpirtitrat e tyre rridhte dëshira dhe bindja për të ecur në rrugën e Zotit dhe për të vënë në jetë parimet fetare. Dhe si mund të bëhej më mirë një punë e tillë sesa mbi bazën e sadakasë. Të dhurosh diçka nga


vetja pasi edhe vetë profeti e tha:

*“Nuk është besimtar i mirë ai që nuk mendon për vëllanë e tij besimtar atë që mendon për vete.”*

Këta njerëz u bashkuan në një rreth të vetëm, mbi një emërues të përbashkët, **“Sadakanë”** për të dhënë diçka, e cila padyshim do të ishte brenda një vije të caktuar dhe një vijëmsie të plotë. Një shumë e tillë, e cila fillimisht do të ishte e pakët, do të shkonte në shërbim të masës së gjerë të popullit. Këta njerëz kishin për qëllim të kontribuonin fillimisht në fushën e arsimit dhe të dijës, duke hapur kurse të ndryshme ku do të mësohej abc’ja e Kuranit famëlartë dhe fjalët e arta të Profetiti tonë Muhamedit (a.s). Ky do të ishte vetëm fillimi, pasi më pas grupimi do të merrte një rrjedhë akoma edhe më të gjërë. Nga dhjetë që mund të ishin në fillim ato do të shtoheshin e shtoheshin duke u kthyer në turma njerëzish të cilët do t’i bashkoheshin një qëllim të njëjtë dhe që në zemrat e tyre ishte fjala e krijuesit të gjithësisë. Vitet do të kalonin dhe punët e këtij grupimi do të shtoheshin dita ditës shumë më tepër pasi vetë Allahu i Lartë në një ajet Kuranor thotë:

*“Dhe do të shohësh teksa njerëzit do të vijnë turma turma drejt fesë së Zotit të tyre”*

Një çelës suksesi u bë sadakaja e tyre, një shumë modeste e dhënë në emër të Allahut me një qëllim të caktuar për të dhënë një ndihmesë në funksion të masës së gjerë të popullit. Nga një kurs i vogël që ishte në fillim, rrethi



erdhi duke u zgjeruar pasi tashmë nuk ishin më aq pak, njerëzit përreth ishin bërë të vetëdijshëm që secili duhet të jepte diçka në këtë shërbim. Kështu fondet e mbledhura arritën shuma mjaft të volitshme, shumë të konsiderueshme dhe në këtë mënyrë planet filluan të zgjeroshin. U ndje nevoja e zgjerimit të fushës së veprimtimit dhe nga një kurs i fillimit tashmë do të kalohej në një institucion arsimor ku do të edukoheshin breza të tërë, institucion ku do të mblidheshin me qindra e mijëra fëmijë që do t’u buzëqeshnin familjeve të tyre për dijet e marra dhe për vlerat e fituara. Këta njerëz më pas hapën dyert e tyre, u hapën zemrat njerëzve dhe i ftuan edhe ata të ishin pjesë e kësaj modestie, që në dukje ishte e tillë, por që përbrenda kishte një botë të tërë. Këta njerëz, pasi kishin dhënë kontributet e çmuara në vendin e tyre tashmë kishin dalë jashtë territorit në vende të tjera, përherë me të njëjtat qëllime. Ajo që i karakterizonte ishte krenaria, zemërgjerësia e pakufishme dhe respekti ndaj qenies njerëzore pasi një tjetër synim i tyre ishte edhe hadithi i profetiti

*“Kush shpëton një zemër njerëzore ka shpëtuar një shoqëri të*






tërë”

*“Kush edukon një njeri ka edukuar një brez të tërë”*

Kudo që shkuan ata treguan veten e tyre, treguan se prej nga vinin dhe se mirënjohja për një-rëzit dhe përhapja e kulturës fetare ishte në thelb të çështjes. Ata ecën përpara përsëri mbi bazën e kësaj sadakaje që tashmë kishte arritur kulminacionet e saj duke u hapur dyert e vendit të tyre shumë të rinjve të huaj në vendet ku ata shkonin, duke u dhënë mundësi të shumëanshme edukimi dhe zhvillimi, duke u hapur fronte jete dhe mundësi të shkëlqyera komunikimi që gjithsecili të gjente vetveten pavarësisht nga natyra apo mentaliteti që gëzonte. Nuk do të ishte aspak e lehtë as për ata që jepnin kontribute sadakaje dhe as për të rinjtë që studionin atje pasi kjo nuk ishte çështje ditësh apo muajsh, por çëhtje vitesh dhe pse jo çështje jetike, ku tashmë secili do të përcaktonte vijën e jetës së tij.



*“Dhe do të shohësh teksa njerëzit do të vijnë turma turma drejt fesë së Zotit të tyre”*

Ata krijuan ambiente të përshtatshme mbi bazën e kësaj sadakaje për këta të rinj, krijuan ambiente familjare që askush mos ta ndiente veten se ishte në një vend të huaj, përkundrazi ta ndjente veten sa më të lirë dhe komod pasi këta të rinjë kishin parasysh tri gjëra mjaft të rëndësishme: Krugën që po bënin, ku po shkonin dhe për çfarë po shkonin, tre parime të cilat i mbanin përherë në formë.

Vitet do të kalonin dhe tashmë këta të rinj do të ktheheshin në vendet e tyre bashkë me përvojën dhe shkollimin e fituar për ta vazhduar këtë mision human dhe fisnik në vendlindjet përkatëse. Dhe këta të rinjë tashmë ishin ndryshe, ishin më të pjekur, më të matur pasi këta njerëz human që kontribuan në jetën e tyre tashmë do të bëheshin bashkëpunëtor me ta. Dhe të gjithë së bashku do të ecnin drej aspiratave të reja.

Padyshim që ky vullnet nuk do të kufizohej vetëm në aspektin e arsimit të të rinjve pasi kjo sadaka kaq e fuqishme që u bë burimi kryesor i një zhvillimi të tillë nuk mund të shtrihej vetëm në një fushë të jetës. Kështu që në hapat e para të kësaj inisiative do të bëheshin në mujore ndihmat ushqimore dhe në veshmbathje për njerëzit në nevojë pasi jeta padyshim që nuk mund të jetë e njëjtë për të gjithë. Humanizmi do të zgjaste dorën e tij të ndihmesës edhe në këtë masë të gjerë të popullatës që kishte kaq shumë nevojë në momentet më kritike të tyre. Këto ndihma do të shtoheshin dita ditës dhe lista e atyre që u përfshinë në këtë ndihmë do të rritej akoma më shumë. Të gjithë këta do t'u ishin përjetësisht mirënjohgës këtyre njerëzve human pasi do të mjaftonte vetëm një dorë e vogël që këta të rimëkëmbeshin duke vazhduar më tej me një jetë normale si gjithë të tjerët. Kjo do të mjaftonte për ta

që të kuptonin që nëse sot ishin që zgjasnin dorën për të marrë, të nesërmen do të ndodhte e kundërta, do të ishin këta që tashmë do të dhuronin diçka nga vetja e tyre, sado e pakët që të ishte, pasi tashmë edhe ata vetë do ta kuptonin thënien profetike:

*“Dora që jep është më e dobishme se dora që merr”*

Ndihmat e shumta në themel të së cilave qëndronte sadakaja po shtoheshin dita ditës dhe mirësia dhe begatia e Allahut të lartë vinte aty nga se prisje pasi këta njerëz nuk sihin thjeshtë dhurues nga ana materiale por edhe nga aspekti shpirtëror pasi mos të harrojmë se para së gjithash këta njerëz dhuronin identitetin dhe shpirtin e një njeriu human dhe njerëzor, dhuronin një zemër dhe një shpresë, dhuronin kurajo për një jetë akoma edhe më të mirë, ishin këta njerëz që u bënë simbol i virtyteve njerëzore pasi jeta e tyre kishte në thelb sadakanë duke patur parasysh edhe thënien profetike:

*“Edhe një buzëqeshje është një sadaka”*


Ata tashmë kishin krijuar një rreth mjaft të gjerë dhe të ngushtë, kishin hapur degëzimet e tyre në katër anët dhe kudo që shkonin kishin lënë një zemër që i priste me shumë dashuri, kudo që hidhnin hapat merrnin buzëqeshjen e të tjerëve dhe padyshim edhe përkrahjen e tyre. Ata ishin të vetëdijshëm se me një akt të tillë, me një proces të tillë po kontribuonin në rimëkëmbjen e një shoqërie e cila do të ishte pararojë e të nesërmeve, një shoqëri e cila po zhvillohej dita ditës dhe po kultivonte në vetvete vlera madhore mbi bazën e kësaj dukurie, pra mbi bazën e sadakasë. Këto ndihmesa nuk u mjaftuan vetëm me kaq pasi nëse bëhej fjalë për shërbim ndaj krijesës më të përkryer, njeriut, atëherë kupto-

het se fushat e jetës do të ishin të gjithanshme prandaj ndihmesa u shtri edhe në fushën e shëndetësisë ku padyshim edhe këtu humanzmi mbi këtë bazë ishte i pakufijshëm pasi mbi çdo gjë do të shërohej një plagë njerëzore, njeriu do të forcohej për t'i bërë ballë vështirësive të jetës. Edhe në fushën e shëndetësisë nuk do të mungonte buzëqeshja dhe mirënjohja të cilat tashmë ishin bërë pararojë për shumë zemra dhe shpirtra njerëzorë. Me anë të këtyre rrugëtimitëve të lodhshme në dukje, por mjaft shprehdhënëse ata u jepnin jetë mjaft zemrave që deri në atë kohë nuk kishin gjetur shpëtim dhe tanimë kjo sadaka e tyre, kjo ndihmesë e tyre ishte dora e sigurtë e një ripërtëritjeje shpirtërore. Ishin sa e sa njerëz që kaluan gjatë kësaj rruge, sa zemra të shëruara, sa shpirtra të qetësuar dhe sa mirënjohje për këta njerëz me kaq zemër të madhe.

Një tjetër dukuri që mori hov

nga kjo nismë e madhe mbi sadakanë ishte edhe dhënia e ndihmave mujore në ushqime dhe veshmbathje për familjet e varfëra dhe në nevojë, një nismë kjo që padyshim gjeti një përkrahje mjaft të madhe dhe solli një zhvillim të dukshëm të shoqërisë. Kjo përbënte një nismë pasi kuptohej se ishte e pamundur të përballoeshin të gjitha familjet në nevojë pasi edhe nevojat për ndihma ishin të panumërta dhe mundësitë ishin të kufizuara, por gjithsesi të nisur me moton që "më mirë pak se hiç" u mundësua realizimi i një shërbimi të tillë. Njerëz të varfër, me gjëndje mjaft të ulët ekonomike përfitonin nga këto ndihmesa një zemër njerëzore me shpresë se kjo gjëndje do të ishte kalimtare dhe se një ditë edhe ata do të bëheshin të zotët e vetes.

Ajo që shënonte një nga kulminacionet e kësaj nisme ishte momenti i kurbanit të bajramit dhe shpërndarja e mishit nevojtarëve. Një moment mjaft delikat dhe kuptimplotë për vetë faktin se paketa të shumta mishi prisnin duart e shumë njerëzve në nevojë. Njerëz të moshave dhe profesioneve të ndryshme merrnin në duar një pako mishi si atribut i kësaj dite madhështore me anë të së cilë njoftohej se të gjithë myslimanët festonin në mënyrë të barabartë ditën e një sakrifice dhe mundimi gjithmonë në emër të Krijuesit të Gjithësisë. Tashmë pjesa më e madhe e njerëzve do të bëheshin dëshmitarë se një sadaka e dhënë para shumë kohësh tashmë po merrte frytet e veta për një shoqëri të tërë dhe



po ndihmonte në një rimëkëmbje të kësaj shoqërie, një punë kjo e cila nuk rezultonte thjeshtë vetëm në një vend të caktuar, por e shtrirë në shumë krahina, në shumë shtete, të Ballkanit, të Europës dhe në botë.

Vitet kalonin njëra pas tjetrës dhe brezat rriteshin dhe edukoheshin me një frymë të tillë duke gdhendur në horizontet e tyre gjurmë të arta të shërbimeve finansike ndaj qenies më të mrekullueshme. Me kalimin e këtyre viteve do të evoluonin edhe aktivitetet e ndryshme kulturore dhe artistike, do të degëzoheshin vizitat dhe bashkëpunimet reciproke pasi tashmë nismëtarë të kësaj sadakaje nuk do të ishin vetëm pesë apo dhjetë veta, por me qindra e mijëra në çdo kënd të botës të cilët do të punonin në shërbim të aspiratave të vendeve të tyre, në shërbim të rimëkëmbjes së një shoqërie e cila si falënderim për këtë do të shprehte një shprehje të vetme dhe kuptimplotë

*"Zoti ua shpërbleftë për gjithçka!"*

*"Dora që jep  
është më e  
dobishme se dora  
që merr"*

# Fetva mbi bid'atin dhe veprimin me të

## Pyetje:

Cila është domethënia e bidatit, si kanë vepruar dijetarët e umetit me bidatin, cili është të kuptuarit e vërtetë të çështjes së bidatit?

## Përgjigje:

Për ta njohur domethënien e bidatit dhe për ta kuptuar të vërtetën e tij, është patjetër që të njihemi me domethënien e tij nga aspekti gjuhësor, dhe domethënien e

tij nga aspekti terminologjik i sheriatit. Atëherë le të fillojmë me domethënien gjuhësore.

## Domethënia gjuhësore e bidatit

Bidati është risi (hadeth) dhe ajo që është bërë në fe pas plotësimit të saj. Ibn Sukejti thotë: Bidati është çdo risi. Fjala risi në traditë zakonisht përdoret në kontekst të përçmimit. Ebu

Adnan thotë: Rismëtarri (mubtedi) është ai i cili shpikë një çështje të cilën nuk e ka paraprirë askush më parë përveç tij. Filani është rismëtar në këtë çështje, do të thotë: i pari që nuk është paraprirë nga askush. Thuhet nuk është për mua rismëtar dhe as novator... Fjala bidat vjen në format e saj foljore: që do të thotë: bëj risi. Allahu i madhëruar thotë: "**...ndërsa murgërinë ata vetë e shpikën...**"<sup>1</sup>; pastaj në formën foljore: - e

ka akuzuar për bidat, - e ka llogaritur për bidat; - risi e çuditshme, po ashtu -do të thotë: novator shpikës, kurse – do të thotë 'kam shpikur një gjë jash-të çdo modeli paraparak'.<sup>2</sup>

## Domethënia terminologjike e bidatit

Nga aspekti terminologjik i sheriatit, ekzistojnë dy mënyra të përkufizimit të bidatit.

Mënyra e parë: është mënyra e Izz bin Abdis-Selam, i cili bidatin e definon si një gjë që Pejgamberi a.s. nuk e ka vepruar, dhe e ndanë në disa dispozita, ku thotë: "Bidati është një veprim që nuk ka ekzistuar në kohën e Pejgamberit a.s. dhe ndahet në: bidat i obliguar; bidat i ndaluar; bidat i rekomanduar; bidat i urryer dhe bidat i lejuar. Kurse rruga për të njohur se çfarë bidati është, nevojitet që akëcilin ta parashtrijmë përpara rregullave të sheriatit: nëse ai (bidati) hyn në kategorinë e gjërave të obliguara, atëherë ai është vaxhib – i obliguar; nëse hyn në kategorinë e të ndaluarave, është haram – i ndaluar; nëse hyn në kategorinë e rekomandimeve, ai është mendub – i rekomanduar; nëse hyn në kategorinë e urryer, ai është mekruh – i urryer; e nëse hyn në kategorinë e të lejuarës, ai

1. Kur'ani, El-Hadid:27.

2. "Lisanu'l-arabi", vëll VIII, fq.6, materia (bede'a)

është mubah - i lejuar.<sup>1</sup>

Këtë domethënie e vërteton edhe Imam Nevevi r.h. kur thotë: "gjithçka që nuk ka qenë në kohën e Pejgamberit a.s. quhet bidat, mirëpo ka nga ai që është i mirë, dhe po ashtu ka që është në kundërshtim me këtë"<sup>2</sup>

Mënyra e dytë: është ajo e cila të kuptuarit e bidatit në kuadër të kuptimit terminologjik e bën më të veçantë nga të kuptuarit e tij në gjuhë. Prandaj bidatin e konsideron vetëm si të përçmuar dhe nuk e quan fare me dispozitën e vaxhibit, mendubit, mubahit dhe mekuruhit, sikurse veprimi Izz. Kjo mënyrë e të kuptuarit të bidatit, e ngushton atë vetëm në të ndaluar. Prej atyre që e mbrojnë këtë qëndrim, është **Ibn Rexhep El-Hanbeli r.h.** i cili e qartëson këtë domethënie kur thotë: "Bidati nënkupton atë risi e cila nuk ka bazë në shariat që dëfton për mbështetjen e saj, ndërsa, nëse ka bazë në shariat që dëfton për mbështetjen e saj, atëherë ajo nuk llogaritet bidat, edhe pse nga aspekti gjuhësor e meriton të quhet e tillë."<sup>3</sup>

Në të vërtetë që të dy mënyrat dakordohen mbi të kuptuarit e realitetit të bidatit, megjithëse ndryshimin e tyre në fillim, që çojnë deri te kuptimi për të cilin janë unikë se bidati i përçmuar vepruesi i të cilit bën mëkat, është ai bidat i cili nuk ka bazë në shariat që dëfton për të, dhe kjo është ajo që Resulullahu a.s. e ka thënë: – "disa prej bidateve janë devijim"<sup>4</sup>

Kështu në këtë kuptim të qar-

1. El-Izz bin Abdus-Selam, "Kava'idu'l-ahkami fi mesalihu'l-anami", 2/204.

2. Ibnul Haxher "Fethul Bari, vëll.II-të, fq.394.

3. Ibnu Rexheb El-Hanbelij "Xhamiu'l-ulumu ve'l-hikemi", fq.223.

4. Transmeton Ahmedi në "Musnedin" e tij, vëll.III, fq.310; Muslimi në "Sahihun" e tij, vëll.II fq.592.

të dhe të drejtë, kanë shkuar imamët (pri-jësit) e juristëve islamë dhe dijetarët e umetit, meritë për t'u pasuar. **Transmeton** imam Bejhekiu nga Imam Shafi'u se ka thënë: Risitë e çështjeve janë dy sosh: E para:ajo çka kundërshtohet nga Kurani apo Suneti apo tradita apo konsensusi i dijetarëve (ixhma), e ky është bidati që shpie në devijim; dhe e dyta: është një bidat i mirë i cili nuk kundërshtohet nga asnjëri prej tyre, prandaj ky është bidat që nuk duhet nënçmuar.<sup>5</sup>

Autoriteti i Islamit Ebu Hamid El-Gazali r.h. thotë: çdo gjë që është bidat nuk është e ndaluar, por i ndaluar është një bidat që kundërshton Sunetin e vërtetuar dhe pezullon një çështje që është prej shariatit"<sup>6</sup>

Gjithashtu transmeton imam Nevevi r.h. nga mbreti i dijetarëve Imam Izzuddin bin Abdisselam, ku Nevevi thotë: "Ka thënë dijetari i madh, imami, për ditoritë e gjera të tij në shkenca të ndryshme, kanë unanimitet dijetarët Ebu Muhammed Abdul Aziz bin Abdusselam në fund të librit të tij "Kavaidu": Bidati ndahet në vaxhib, haram, mendub, mubah... etj.<sup>7</sup>, po ashtu në një vend tjetër në thënien e tij mbi "shtrëngimin e duarve" pas namazit, ne do ta veçojmë prej saj

5. Transmeton Bejhekiu me senedin e vet në librin "Menakibu'sh-shafijj". Po ashtu e transmeton Ebu Neim në "El-Hul-lijetu" 9/113.

6. Ebu Hamid El-Gazalijju, "El-Ihja'u", pjesa e II-të fq.248.

7. "Tehdhibu'l-esmai vel-lugati", pjesa e I-rë, botim i "el-mirijetu", fq.22.

fetvanë nr. 66, ai thotë: "Dije se këto "shtrëngim duarsh" janë të rekomanduara (mustehab) në çdo takim, ndërsa sa i përket asaj që e kanë bërë zakon njerëzit për "shtrëngimin e duarve" vetëm pas dy namazeve, atij të sabahut dhe të ikindisë, nuk ka bazë në shariat në këtë mënyrë, mbase nuk ka gjë të keqe në këtë, sepse baza e "shtrëngimit të duarve" është sunet, kurse respektimi i këtij suneti nga ana e tyre në disa e raste, e lëshimi i tij në disa të tjera, nuk i përjashton ato nga të qenurit e tyre prej llojit të "shtrëngimit të duarve" e cila ka bazë në shariat"<sup>8</sup>

Ibn Ethiri ka thënë: "Bidati është dy sosh: bidati i mbarë dhe bidati i mbrapshtë. Ai që vjen në kundërshtim me atë që e ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij a.s., i tilli është në sferën e nënçmimit dhe mohimit, kurse ai që vjen në kontekstin e tërësisë së rekomandimeve dhe motiveve të tilla, i tilli është në arenën e lavdërimit" ... pastaj thotë: Bidati i mirë në të vërtetë është sunet, dhe në këtë komentim bartet hadithi:– çdo risi është bidat, në kontekstin që manifestimi i tij ka rezultuar

8. Nevevijju në "El-Edhkar"





ndryshe nga parimet e sheriatit, kurse nuk e kundërshton sunetin<sup>1</sup>.

Po ashtu edhe Ibn Mendhuri r.h. ka një konstatim të mirë rreth bidatit në aspektin terminologjik të tij kur thotë: "Bidati është dy sosh: bidati i mbarë dhe bidati i mbrapshtë. Ai që vjen në kundërshtim me atë që e ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij, i tilli është në sferën e përcmimit dhe mohimit. Ndërsa ai që realizohet nën përgjithësimin e rekomandimeve të Allahut, që ka motive nga fjala e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij, i tilli është në sferën e të lavdëruarave; po ashtu ai që nuk ka ndonjë shembull ekzistues, sikurse është lloji i sexhdeve, i bujarisë, veprat e mira, i tilli është prej veprimeve të lavdëruara. Në këto raste nuk lejohet që ai të jetë në kundër-

shtim me një gjë që ka ardhur sheriatit, ngase Pejgamberi a.s., në fakt ka bërë shpërblim për atë, ku thotë:

"Kush e hap një rrugë të mirë, ai do të ketë shpërblimin e saj dhe të atyre që veprojnë sipas saj", ndërsa për të kundërtën e tij thotë:

"Kush e hap një rrugë të keqe, ai do të ketë ndëshkimin e saj dhe të atyre që e veprojnë atë", kjo kur bidati është në kundërshtim me atë që e ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Thotë (Ibn Mendhuri) prej këtij lloji (prej llojit që nuk e kundërshton urdhrin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij), është thënia e Omerit r.a.: "Ç'bidat i mirë është ky!, pasi që ky është prej veprave të mira dhe bënë pjesë në sferën e lavdërimit, e të cilin e quajti bidat dhe e lavdëroi, ngaqë Resulullahu a.s. nuk ua pati bërë sunet atyre. Ai (Pejgamberi a.s.) e fali atë disa net, pastaj e la dhe nuk e përfilli, gjë që as njerëzit nuk u tubuan për të. Dhe kjo vazhdoi të mos jetë edhe në kohën e Ebu Bekrit. Mirëpo Omeri r.a. i tuboi njerëzit ndaj saj (teravisë) dhe ua rekomandoi një gjë të tillë. Për këtë arsye e quajti "bidat", që në të vërtetë është sunet në bazë të thënies së Pejgamberit a.s.

"Përmbajuni sunetit tim dhe traditës pas meje të halifëve besimdrejtë..." dhe thënies së tij

"Pranoni për liderë ata dytë pas meje, Ebu Bekrin dhe Omerin.

Në këtë frymë bartet hadithi – "çdo risi është bidat", me të cilin synohet ai bidat që i kundërshton parimet e sheriatit dhe që nuk pajtohet me Sunetin"<sup>2</sup>

### Si kanë vepruar dijetarët në

### raport me të kuptuarit e bidatit

Shumica e dijetarëve të ume-tit (xhumhur) që janë meritore për t'u pasuar, në raport me bidatin kanë vepruar në kontekstin se ai (bidati) është disa llojesh, sikurse kjo është e qartë prej fjalës së Imam Shafijut dhe ndjekësve të tij: Izz bin Abdus-selam, Nevevi dhe Ebu Shame-te; prej malikinjve: El-Kirafi dhe Ez-Zurkanij; prej hanefinjve: Ibnu Abidini; prej hanbelinjve: Ibnul Xhevzije; dhe prej dhahirinjve: Ibnu Hazmi. Ndërsa të gjitha këto aspekte, pasqyrohen në definicionin e Izz bin Abdusselam mbi bidatin e ky është se: bidati është një veprim që nuk ka ekzistuar gjatë kohës së Resulullahut a.s. dhe ndahet në bidat vaxhib, bidat haram, bidat mendub, bidat mekruh, dhe bidat mubah"<sup>3</sup>

Ata (dijetarët) për të gjitha këto lloje të bidateve kanë sjellë shembuj:

- bidat i obliguar, sikurse është marrja me sintaksës me anë të së cilës arrihet të kuptohet fjala e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij. Mësimi i saj është vaxhib – i obligueshëm, ngase patjetër që me anë të saj bëhet mbrojtja e sheriatit. Vaxhibi derisa nuk plotësohet, ai nuk është tjetër pos vaxhib.
- bidat i ndaluar (haram), sikurse janë shembuj nga pikëpamjet e kaderinjve, xhebrinjve, murxhinjve dhe havarixhëve.
- bidat i rekomanduar (mendub), sikurse është krijimi i shkollave, ndërtimi i kubeve, pastaj falja e namazit të teravisë me imam dhe xhematë në xhami.

1. Ibni Ethiri "En-Nihaje", pjesa e I-rë, fq.80, boton 'el-hajrije', Egjipt.

2. "Lisanu'l-arab", pjesa e VIII-të, fq.6

3. El-Izz bin Abdus-Selam, "Kava'idu'l-ahkami fi mesalihil-anami", 2/204.

- bidat i urryer (mekruh), sikurse është dekorimi i xhamive, stolisja e mus'hafave.

- bidat i lejuar, sikurse është 'shtrëngimi i duarve' pas namazit, po ashtu zgjerimi i shijes në haje, pije, veshje.

Qëndrimin e tyre mbi ndarjen e bidatit në pesë dispozita, dijetarët e kanë argumentuar me argumente:

1. Thënia e Omerit r.a. - ç'bidat i mirë është ky!, për faljen e namazit të teravisë me xhemat në Ramazan. Transmetohet nga Abdurrahman bin Abdul Kari, i cili ka thënë: Dola me Omer bin El-Hattabin r.a. në xhami, një natë në Ramazan, ku ja njerëzit të shpërndarë, njëri falej në vete, tjetri falej e me të falej një grup. Omeri r.a. tha: vërejtja se sikur këta t'i bashkoj të gjithë pas një imami të vetëm, do të ishte diçka she-mbull, pastaj kështu vendosi dhe i bashkoi (në një xhemat) pas Ubej bin Kabit. Pastaj kam dal me të një natë tjetër, ndërsa njerëzit faleshin namazin pas një imami. Me atë rast Omeri tha: - ç'bidat i mirë është ky!, ata që janë duke fjetur janë më me vlerë se sa këta që janë të ngritur, duke e dëshiruar me këtë faljen në pjesën e fundit të natës, ngaqë njerëzit faleshin në fillim të saj.<sup>1</sup>

2. Emërtimi i namazit të duha-së me xhemat në xhami bidat, nga ana e Ibni Omerit, ndërsa ai (namazi) është prej punëve të mira. Transmetohet nga Muxhahidi se ka thënë: kam hyrë unë dhe Urvete bin Ez-Zubejri në xhami, kur ja Abdullah bin Omeri qëndronte i ulur te dhoma e Aishes r.a., ndërsa njerëzit e falnin në xhami namazin e duha-së. Ndaj ne

1. Transmeton Buhariu në "Sahihun" e tij, vëll.II-të, fq.707.

e pyetëm atë për këtë namaz të tyre, e ai tha: është bidat.<sup>2</sup>

3. Hadithet të cilat e favorizojnë ndarjen e bidatit në të mirë dhe të keqe. Prej tyre është hadithi me transmetim merfu':

" Kush e vë në praktikë një rrugë të mirë, ai do ta ketë shpërblimin e saj dhe të atyre që veprojnë sipas saj deri në Ditën e Kiametit, ndërsa kush e vë në praktikë një rrugë të keqe, ai do ta ketë ndëshkimin e saj dhe të atyre që veprojnë sipas saj deri në Ditën e Kiametit"<sup>3</sup>

Në bazë të kësaj që u tha gjer më tani, bëhet e qartë se ekzistojnë dy vështrime:

Vështrimi në mënyrë të përgjithshme, e cila është ajo që ka shkruar Ibn Rexheb El-Hanbelij r.h. dhe të tjerë se veprat për të cilat njeriu meriton shpërblim dhe që kanë bazë në sheriat si veprim, në aspektin terminologjik të sheriatit nuk quhen bidat, edhe nëse është i drejtë emërtimi i tyre si bidat në aspektin gjuhësor. Pra, ai me këtë e synon se nuk quhen bidate të urryer nga aspekti i sheriatit

Vështrimi në mënyrë të detajuar, është ajo që e ka potencuar Izz bin Abdisselam r.h. dhe ne e kemi prezantuar detajisht.

E gjithë ajo që u tha, nevojitet për myslimanin që të informohet për këtë çështje, e cila ka qenë prej çështjeve më të rëndësishme nga e cila është ndikuar

2. Transmeton Buhariu në "Sahihun" e tij, vëll.II-të, fq.630, Muslimi në "Sahihun" e tij, vëll.II-të, fq.917.

3. Transmeton Muslimi në "Sahihun" e tij, vëll.II-të, fq.705.



mendimi islam, për mënyrën e trajtimit të saj në kontekst të çështjeve të fikhut dhe kështu të ketë kujdesin e tij ndaj vëllezërve të tij mysliman, ngase ndodhë që një injorant, nga padituria të gjykojë ndaj të tjerëve se janë bidatxhinj dhe mëkatarë të mëdhenj. Mbrojtja është te Allahu për shkaqet e injorancës së tij në këto parime që janë fare të qarta, e të cilat kohët e fundit u bën objektiv i konfuzionit dhe çudisë.

Vetëm tek Allahu kërkojmë shpëtim. Vetëm Ai është i Lartëmadhëruar dhe i Gjithëditur.

Përktheu nga gjuha arabe:

**Orhan Bislimaj**

Burimi: Ali Xhumaja (mufti i Egjiptit) "El-Bejanu lem-ma jushgalu'l-edh'han', boton: el-mukhadu lin-neshri vet-tevzi", 2005, Kairo – Egjipt, fq. 204-209.



# Ajete

“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e gjykimit) në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi as ndërmjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë”.

(Bekare: 254)



“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllojnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër atij që donë; Allahu është mirëbërës i madh dhe Gjithëdijsëm”.

(Bekare: 261)



“Me të vërtetë, jobesimtarët e shpenzojnë pasurinë e tyre, për t’i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë vetëm dëshpërim për ta, sepse, do të jenë të mundur. E, ata që nuk besojnë, do të tubohen në xhehenem”.

(Enfal, 36)



“Ata që e grumbullojnë arin dhe argjendin dhe nuk e shpenzojnë në rrugën e Allahut (ashtu si janë urdhëruar), paralajmëroji me dënim të dhimbshëm”.

(Tevbe, 34)



“Ata që lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi, ata e shpresojnë në një fitim që kurrë nuk humbet”.

(Fatir, 29)



“Të pyesin se ç’do të japin. Thuaj: “Atë që jepni prej pasurisë jepni për prindërit, jepni për të afërmit, për bonjakët, për të varfërit, për kurbetçinjtë. E çdo të mirë që punoni, s’ka dyshim se All-llahu e di.”

(Bekare: 215)



“Dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes.”

(Furkan: 67)



# Hadithe

“Në çdo bashkim ka lëmoshë, madje për çdo ditë në të cilën lind dielli; të mbash drejtësi mes dy njerëzve është lëmoshë; t’i ndihmoh dikujt që të hypë në kafshën e tij është lëmoshë; fjala e mirë është lëmoshë; çdo hap të cilin e bën besimtari për të shkuar në xhami është lëmoshë dhe heqja e gjërave dëmtuese nga rruga është lëmoshë!”



(Buhari, Muslim)

“Nuk pakësohet pasuria prej sadakasë”



(Muslim)

“Çdo punë e mirë është sadaka”



(Buhari)

“Secili njeri do të jetë nën hije të sadakasë së tij derisa të gjykohet mes njerëzve”



(Ahmedi, Hakimi)

“Nëse njeriu vdes, i ndërpriten veprimet e tij, përveç se në tre raste: nëse ka lënë një lëmoshë të vazhdueshme, ose një dijeqë njerëzit marrin dobi prej sajë, ose një fëmij të mirë, që lutet për prindërit e tij”.



(Muslimi, Tirmidhi)

“Vepra me e dashur tek Allahu xh.sh. është gëzimin që ia dhuron muslimanit, brengjen, të cilën ia largon, ose borxhin të cilin ia paguan ose urine të cilën ia largon”.



(Bejhekiu)

“Veprat e mira të ruajnë nga arenat e të këqijave, sëmundjeve dhe shkatërrimeve”.



(Hakimi)

“Sadakaja i shuan gjynahet sikurse uji që shuan zjarrin”.



(Tirmidhiu)

Kur e kanë pyetur Pejgamberin a.s. për sadakanë më të vlefshme, ai është përgjigjur: “Sadakaja në varfëri”.



(Ahmedi, Nesai, Ebu Davudi)





# Buzaria dhe dhurimi

**S**henja më e qartë dhe shfaqja më e plotë e mëshirës, frytit të parë të besimit, është dhurimi. Dhurim do të thotë t'ia dedikosh qenien dhe pasurinë Allahut. Jetët e profetëve, që janë kulmi i virtytit njerëzor, dhe të dijetarëve të fesë, arifëve dhe velive, që janë pasardhësit e peygamberëve, janë të mbushur plot e për plot me rrëfime të panumërta të shembujve të tyre të mëshirës dhe dhurimit.



Garat për punë të mira

Një ditë prej ditësh profeti Muhamed (a.s.) pasi e fali namazin e sabahut sëbashku me sahabet e tija, u kthye drejt tyre dhe i pyeti:

- A ka agjëruar ndokush prej jush sot?

Umeri (r.a.) i tha:

- O i dërguari i Allahut! Nuk më ka ardhur ndërmend mbrëmë që të agjëroja ditën e sotme.

Ndërsa Ebu Bekri (r.a.) tha:

- Unë që mbrëmë mendova që të agjëroja, prandaj sot kam gdhirë agjërueshëm.

Profeti Muhamed (a.s.) sërish pyeti:

- A ka vizituar ndonjëri prej jush ndonjë të sëmurë sot?

- O i dërguar i Allahut, - ia priti Umeri, - sapo kemi falur namazin e sabahut dhe nuk kemi pasur asnjë çast kohë të shkojmë të vizitojmë ndokënd.

- Unë mora vesh se Abdurrahman bin Avf qe sëmurë, prandaj ndërsa po vija për në xhami ndala tek shtëpia e tij ta pyesja se si ishte me shëndet sot,- tha Ebu Bekri.

- A keni ushqyer ndonjë të varfër sot,- pyeti për të tretën herë profeti Muhamed (a.s.)



*“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpigu fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!”*

*(Inshirah, 7-8)*



- O i dërguar i Allahut,- ia priti Umeri, - sapo jemi falur dhe ende nuk kemi dalë nga xhamia.

- Ndërsa unë, - tha Ebu Bekri, - pashë një të vobegtë teksa po hyja në xhami. Ia mora nga dora copën e bukës birit tim Abdurrahmanit dhe ia dhashë atij të ngrati.

Pas këtyre fjalëve profeti Muhamed (a.s.) tha:

- Të përgëzoj me xhenetin, o Ebu Bekër!

Umeri filloi të rënkonte dhe thoshte me zë të ulët “xheneti, ah xheneti!” Profeti Muhamed i tha atij:

- Allahu e mëshiroftë Umerin, Allahu e mëshiroftë Umerin. Sa herë që dëshiron të kryej një vepër të mirë Ebu Bekri ia kalon atij.” (Hejthemi, III, 163-164; Ebu Davud, Zekat, 36/1670; Hakim, I, 571/1501)

Mësimi më i rëndësishëm që nxjerrim nga ky hadith është fakti që besimtari duhet të jetë çdo çast në kërkim të kryerjes së një veprë dhe akti që do të bëhej shkak që ait ë fitonte kënaqësinë e Allahut.

Në ajetin fisnik thuhet

**“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpigu fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!”** (Inshirah, 7-8)

Një herë profeti u tha kështu sahabeve të tij:

- Nuk ka njeri që do të vdes dhe nuk do të pendohet! Kur sahabet e pyetën se për ç’arsye çdo njeri do të pendohet ai iu përgjigj:

- Në qoftë se njeriu që vdes ka qenë bamirës dhe njeri i mirë do të pendohet që nuk është përpjekur të jetë edhe më shumë bamirës dhe të kryente vepra të mira, ndërsa në se ai është keqbërës, do të pendohet që nuk ka arritur ta frenojë veten nga të këqiat dhe ta përmirsonte jetën e tij fetare. (Tirmidhi, Zuhd, 59/2403)

Allahu i përkufizon në këtë mënyrë në Kur’anin e shenjtë njerëzit e mirë me të cilët ai është i kënaqur: **“Ata besojnë Allahun dhe Ditën e Kiametit, e urdhërojnë të mirën, e ndalojnë të keqen dhe nxitojnë për të bërë punë të mira. Këta janë ndër të drejtët.”** (Ali Imran, 114) Besimtarët duhet ta kthejnë në natyrën e tyre këtë garë për kryerjen e sa më shumë veprave të mira. Besimtari duhet të jetë zemërdhëmbshur si flladi dhe bujar si shiu i lehtë, në kërkim të kënaqësisë së Zotit duke i dhuruar prehje dhe qetësi çdokujt dhe çdogjëje që ndodhet përreth tij.

Kjo është arsyeja që miqtë e Zotit i ngjasojnë në me bujaritë e tyre përrenjve të begatë, duke rrjedhur e shkuar drejt Zotit të tyre pasi kanë kaluar udhë të gjata nëpërmjet të cilave u kanë dhuruar qetësi dhe prehje mijëra krijesave, njerëzve, kafshëve, pemëve, zogjve, trëndafilit dhe zymbylit. Dhurimi i vërtetë është kërkimi i kënaqësisë hyjnore, ndërkohë që i drejtohesh



mbarë krijesave me një zemër dhe shpirt të mbushur me sinqeritet, mëshirë dhe vetëmohim. Të rendësh në ndihmë të nevojtarëve me të gjitha mundësitë që ke në mënyrë që të përm-bushësh privimet në këtë jetë të të tjerëve.

Zoti ynë e ka vlerësuar si një ndër obligimet shoqërore më të rëndësishme dhurimin, si rezultat i natyrshëm i nderit njerëzor dhe shprehja më fisnike e ndërgjegjeve të kulluara të mbujtura me ndjenja mëshire dhe keqardhjeje. Nuk ka dyshim se kjo është një nga favoret e Tij të veçanta. Pra Zoti i ka urdhëruar njerëzit që një pjesë të vogël të mirësive dhe begative të kësaj jete që Ai u ka falur, t'ia kthejnë sërish Atij në shenjë falenderimi nëpërmjet dhurimit në emër të Zotit, duke e shndërruar këtë akt në një shkak për faljen e gjunaheve dhe një portë të rëndësishme që të shpie në lumturinë e përjetshme.

Virtyti që e lartëson fenë: bujaria

Bujaria është kapitali i vetëm i zemrës i nevojshën për përmbushjen e adhurimit të dhurimit.

Do të ishte e kotë që nga kopshtet e shpirtërave, në të cilat nuk është shpërndarë fara e bujarisë, të kërkoje të mblidhje frutat e dhurimit.

Në hadithin profetik tregohet me këto fjalë se si bujaria shndërrohet në mjet për fitimin e dashurisë dhe afinitetit hyjnor:

“Allahu është bujar, bamirës, prandaj e do fort edhe bujarinë, edhe moralin e lartë...” (Sujuti, Xhamiu’s-sagir, I, 60)

Bujaria, shija e vërtetë e besimit, bën që të fitohet si dashuria e njerëzve, ashtu edhe ajo e Zotit. Në një hadith kudsit thuhet:

“Kjo është feja që unë zgjodha për Vetën time dhe jam i kënaqur me të. Asaj i ka hije vetëm bujaria dhe morali i lartë. Përsakohë që jetoni si muslimanë, lartësojeni fenë me këto dy virtyte.” (Hejthemi, VIII, 20; Ali el-Muttaki, Kenz, VI, 392)

Bujaria është rezultat i besimit të plotë tek Allahu dhe ahireti. Sa bukur e shpreh këtë të vërtetë Aliu:

“Besimi është si një pemë, rrënja e të cilit është

të njohja e sigurtë, degët e saj është devotshmëria, drita e saj është turpi dhe fruti i saj është bujaria.”

Sadi Shirazi e ka shprehur me këto fjalë pririmin nga ky virtyt i lartë, duke e përngjasuar këtë fakt me një copë dru që hidhet në zjarr:

“Bujari është si pema që jep fruta, ndërsa koprraci është si pema që rritet në mal.”

Dy sëmundjet e mëdha: shpenzimi pa fre dhe koprracia

Shpërdorim do të thotë të shpenzosh vetëm për vete, ndërsa koprraci do të thotë të grumbullosh vetëm për vete. Që të dyja janë shfaqje të egoizmit dhe grykësisë. Një rob i Zotit me këto cilësi është i refuzuar nga kënaqësia hyjnore.

**“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë.”**  
(el-Isra, 29)

**“Dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes;”** (el-Furkan, 67)

Gazaliu e ka përkufizuar bujarinë si “ekuilibri që vendoset ndërmjet shpërdorimit dhe koprracisë”.

T’i japësh hakun pasurisë që zotërohet është e mundur vetëm nëse njeriu nuk e shpenzon atë në vende të ndaluara fetarisht dhe duke qëndruar larg dy rreziqeve të mëdha për pasurinë që janë shpërdorimi dhe koprracia. Fatkeqësia e kamjes janë syri i pangopur, koprracia dhe dëshira për t’u pasuruar përherë e më shumë, ndërsa shërimi prej tyre arrihet nëpërmjet bujarisë.

Nga ana tjetër, fatkeqësia e bujarisë është shpërdorimi, pra të shpenzosh gjërat duke i bërë rrush e kumbulla me mendimin se je duke u treguar bujar dhe të shpenzosh paratë në vende të panevojshme.

Por teksa flasim rreth dhurimit duhet të tërheqim vëmendjen rreth faktit që shpërdorim nuk do të thotë vetëm të shpenzosh në sasi të mëdha. Ashtu sikur se shpenzimi qoftë në sasi të mëdha ose në sasi të vogla numërohet për shpërdorim, ashtu edhe shpenzimi në një vend të duhur nuk vlerësohet për shpërdorim në qof-


të se është në sasi të mëdha, përkundrazi meriton të vlerësohet dhe të merret për shembull. Shembullin më të bukur rreth kësaj të vërtete e ka shprehur Ebu Bekri (r.a.) kur e dhuroi të gjithë pasurinë e tij për hir të udhës në të cilën ftonte i dërguari i Allahut.

Nga ana tjetër, kopraci nuk do të thotë të japësh në sasi të vogla, por të mos dhurosh në atë masë që zotëron të ardhura material, sepse të gjithë njerëzit janë përgjegjës në masën që ata kanë mundësi të kryejnë vepra të mira.

Dhurimi i gotës së ujit, pas betejës së Jermukut, të cilën tre shehidët kërkonin t’ia dhuronin njëri-tjetrit edhe teksa po jepnin frymën e fundit, por që në fund mbeti e papirë nga asnjëri prej tyre, i ka tejkalluar mijëra e mijëra shembuj dhurimesh që mund të vlerësohen të mëdha për shkak të vlerave monetare që janë shpenzuar. Ajo që ishte e rëndësishme nuk që një gotë ujë, por madhështia e pasurisë shpirtërore që u ekspozua atë ditë.

E parë nga ky aspekt, poqese dhurimi i sasive të vogla monetare do të numërohej për kopraci, atëherë vetëm njerëzit e kamur do të kishin të drejtë të cilësoheshin për bujar. Por, pasuria





*“Namazi të shpie në gjysmë të udhës për tek Zoti, agjërimi të ndihmon të mbërrish tek porta e Tij, ndërsa sadakaja të mundëson të takohesh me Të.”*

dhe varfëria janë një caktim hyjnor që shoqërohen në këtë botë sëbashku me enigmën e provimit në këtë jetë. Njeriu nuk e ka në dorë të jetë i kamur apo i varfër. Prandaj bujaria dhe kopracia nuk janë çështje pasurie dhe të ardhurash material, por çështje zemre.

Kjo do të thotë se edhe një besimtar pa të ardhura mund të jetë bujar dhe duhet të jetë, sepse kështu na mëson feja jonë. Prandaj bujaria dhe kopracia është e varur jo me faktin se sa zotërojmë mundësi material, por në ç’masë i dhurojmë ne ato.

Profeti ynë Muhamedi (a.s.) e nxiste çdo besimtar mysliman, të varfër apo të pasur që të dhuronin për hir të Allahut, dhe u pat shprehur kështu për njeriun që nuk ka të dhuroj përveç se një hurme: “Shpëtojeni veten nga zjarri i xhehenemit, qoftë edhe me një gjysëm hurme, poqese nuk zotëron qoftë edhe një kokërr hurme, atëherë ruajeni veten nga ai zjarr duke folur vetëm fjalë të mira dhe të sinqerta.” (Buhari, Edeb, 34)

Ja edhe disa shembuj nga fjalët inkurajuese të profetit në lidhje me këtë çështje:

*“O Aishe! Mos e kthe të varfërin mbrapsht, qoftë duke i dhuruar edhe një gjysëm hurme.”* (Tirmidhi, Zuhd, 37)

*“Buzëqeshja ndaj vëllezëve tuaj të fesë është sadaka.”* (Tirmidhi, Bir, 36)

Profeti e pat këshilluar me këto fjalë sahabin e tij Ebu Derda që dihej se nuk kishte të ardhura: *“Kur të gatuash supë hidhi ujë asaj në mënyrë që të mund t’u japësh ndonjë gjë edhe fqinjëve tuaj që nuk kanë se ç’të hanë.”* (Ihja, I, 626)

#### **Ilaçet e zemrës së sëmurë: Bujaria dhe dhurimi**

Pas çdo adhurimi që kryhet zemra dhe shpirti i besimtarit fitojnë hijeshi, virtyte dhe vlera shpirtërore të veçanta dhe të rralla, të cilat janë shumë të rëndësishme që njeriu të mund të shpëtojë nga cilësitë bruto të vetvetes në mënyrë që të shndërrohet në një besimtar të përkryer.

Umer bin Abdulaziz – r. a. – ka thënë:

*“Namazi të shpie në gjysmë të udhës për tek Zoti, agjërimi të ndihmon të mbërrish tek porta e Tij, ndërsa sadakaja të mundëson të takohesh me Të.”*

Po qe se do të analizohet me kujdes kuptimi i fjalës “dhurim”, do të vërehet se një urtësi e këtij adhurimi është superioriteti që i fal ai shpirtit, karakterit dhe personalitetit të njeriut duke e shpëtuar atë nga robëria e materies për ta ngritur drejt botës shpirtërore. Prandaj mund të thuhet se nga ky aspekt dhurimi është në mesin e adhurimeve të tjera që i fal shpirtit njerëzor përfitimin më të madh, “prehjen dhe qetësinë shpirtërore”.

Ali Isfehani e ka shprehur me këto fjalë këtë të vërtetë:

“...Kërkova të mësoja se si mund të mos punoja gjunahe dhe e gjeta zgjidhjen vetëm atëherë kur braktisja pjesën më të madhe të mubaheve me frikën se mos kryej diçka të dyshimtë fetarisht; kërkova rrugën që të jepja lehtëllëgjësi dhe e gjeta shpëtimin tek heshtja; kërkova prehjen dhe qetësinë dhe e gjeta në dhurimin me bujari.”

Çdo besimtar është përgjegjës ndaj rrethit të tij dhe nuk mund të qëndrojë indiferent ndaj klithmave të nevojtarëve dhe të shtypurve. Ai duhet të jetë i pushtuar nga emocionet që të falin bujaria, dhurimi, dhembshuria, altruizmi, zemërbutësia.

Allahu e ka shndërruar në shkak për njëritjetrin njerëzit në mënyrë që ata ta sigurojnë rizkun e tyre. Prandaj, të interesohesh për nevojtarin dhe të ndash për të pjesë nga begatitë që na ka dhuruar Allahu në këtë jetë është një virtytë sublim dhe një favor hyjnor. Zemra e besimtarit nuk gjen ngushëllim përderisa ai nuk i fashit me anë të dhurimit klithmat e nevojtarëve.

Mevlana e ka shprehur bukur me këto fjalë këtë të vërtetë:

“Dije mirë se, mbase të duket se pasuria që ke është duke të të dalë duarsh kur ti e dhuron atë, por në të vërtetë jeta shpirtërore e bamirësit fiton mijëra jetë!”

Pasuria e kësaj bote duhet fituar me qëllim fitimin e prehjes shpirtërore dhe lumturisë së ahiretit duke filluar me ndihmën material ndaj të afërmëve për të përfundua tek të ngratët, të papërkrahurit dhe të mjerët e shoqërisë. Po qe

se fitimi i pasurisë bëhet me këtë qëllim vendin e ngurtësisë, sëmundjeve, krizave dhe shqetësimeve që i shkaktojnë zemrave kokëçarjet dhe dyshimet e kësaj jete do ta zenë qetësisë dhe prehja shpirtërore.

Le ta dëgjojmë nga goja e bekuar e profetit ilaçin e shërimit të zemrës së ngurtë që përbën një ndër sëmundet më të mëdha të ditëve tona.

“Po qe se dëshiron të të zbutet zemra, ushqe të varfërin dhe përkëdhele kokën e një jetimi!..”  
(Ahmed bin Hanbel, II, 263)

Mevlana shprehet kështu si të ishte duke e shpjeguar këtë hadith:

“Zemrat që mbyten në varfëri ngjasojnë me një shtëpi që e ka mbytur tymi. Në qoftë se dëshiron që t’ia dëgjosh hallin që kanë atëherë hap një dritare nga të dal ai tym dhe kështu shpirti yt të edukohet.”

Shpirtërat dhe zemrat e zbutura dhe të përsosura në sajë të dhurimeve me bujari përjetojnë gëzimin që të fal kundrimi i mbrojtjes hyjnore në këtë jetë në sajë të dhurimeve dhe bamirësive që kryejnë.



Pasuria që dhurohet bën që pjesa e mbetur të mos pakësohet, të mos humbasë, përkundrazi të begatohet në masë të sinqeritetit që qëndron pas këtyre dhurimeve. Pasuria që dhurohet në rrugën e Allahut do të begatohet ashtu sikurse një pemë frutore që kur ia krasisim degët bëhet edhe më e frytshme.

**“Ata që e shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëlajnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm.”** (el-Bakara, 261)

Pasuria që nuk dhurohet dhe u shpërndalet të varfërve ngjason me ujin që nuk rrjedh dhe i vjen erë.

Zeqati dhe sadakaja e pastrojnë pjesën e pasurisë që mbetet dhe shndërrohen në një koracë mbrojtëse kundër fatkeqsive dhe kokëçarjeve që mund t'i bien në kokë dhuruesit. Në një hadith fisnik thuhet:

*“Nxitoni të jepni sadaka, sepse fatkeqësitë nuk kalojnë përpara vendeve ku është dhuruar ajo.”* (Heythemî, *Mexhmau'z-Zevâid*, III, 110)

Në më shumë se 200 ajete të Kuranit fisnik urdhërohet dhurimi nga pasuria që zotërohet ose inkurajohen besimtarët për një gjë të tillë.

**Dhuro pjesën që mbetet pasi ke plotësuar nevojat tuaja**

Kur në zemra lëshon rrënjë dashuria ndaj Allahut, stadi shpirtëror i besimtarit kalon në shkallën e zuhdit, pasuria dhe paraja nuk të

hyn më në zemër dhe as në sy, por marrin vlerë në masën se sa e plotësojnë ato të qenit mjet për afinitetin hyjnor. Besimtari që kërkon kënaqësinë e Allahut shkon një jetë të thjeshtë dhe pa salltanate duke ditur të mjaftohet vetëm me masën e nevojshme dhe duke kërkuar rrugët se ku mund ta shpenzojë pasurinë e tij.

Brezi i sahabeve që u rrit në klimën e Kuranit dhe sunetit nuk u dhanë pas luksit dhe salltaneteve megjithëse ata u pasuruan me pasuritë që shkonin drejt Medines si rezultat i ekspeditave zgjeruese të ushtrive muslimane, duke mos e ndërruar mënyrën e tyre të përkorë të jetesës dhe dekorin e thjeshtë të banesave të tyre. Ata përjetuan prehjen shpirtërore të pasurisë së vërtetë dhe mbretërinë e zemrës së kënaqur duke e dhuruar pasurinë që ata meritonin. Konsumi pa kufi, obeziteti, luksi dhe krekosja me pasuri, që janë sëmundjet më të egra të kohëve tona, përbënin një stil jetese që brezi i sahabeve nuk e patën njohur kurrë, sepse ata jetonin me vetëdijen se “varri është ndalesa e fundit tek e cila do të shkojnë shpirtërat të nesërmen”.

Urëfëhet se halifi Umer (r.a.) e kryente detyrën e haxhit duke u treguar i kujdesshëm që të mos shpenzonte përmbi nevojat dhe të mjaftohet vetëm me përmbushjen e nevojave personale, në mënyrë që paratë që i tepronin të mund t'i dhuronte si lëmoshë për nevojtarët. Allahu (xh.sh.) e ka sqaruar me shprehjen “pjesën që mbetet pas përmbushjes së nevojave” masën se kur fillon detyra e dhënies. Prandaj, mund të thuhet se kufiri minimal i bujarisë është dhurimi i asaj që tepron nga pasuria dhe për të cilën nuk kemi nevojë.

Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë në lidhje me këtë çështje:

*“O njeri! Të dhurosh si sadaka pasurinë që të tepron pasi të kesh plotësuar nevojat tuaja është në të mirën tënde, mos ta dhurosh atë është në të keqen tënde. Mos harro se dora që dhuron është më e mirë se dora që merr.”* (Muslim, Zekat, 97)

Kjo do të thotë se duhet pasur parasysh gjatë dhënies së lëmoshës mos tejkalimi i sasisë së “nevojës” në shpenzimet personale, caktimi i kësaj sasive brenda kufijve të pranueshëm dhe mundësia për të përdorur mundësitë materiale që e kalojnë këtë kufi.

### **Përpyekja për të shtuar dozën e bujarisë**

Ahmed bin Ebu Verd i përmbledh me këto fjalë cilësitë e miqve të Zotit:

*“Tre gjëra janë që kur forcohen dhe shtohen tek veliu atëherë shtohen edhe tre cilësi të tjera:*

- 1. Kur rriten në post, u shtohet përkorësia dhe modestia.*
- 2. Sa më gjatë të jetojnë, aq më shumë i shërbejnë fesë dhe njerëzve.*
- 3. Sa më të pasur të bëhen, aq më shumë bëhen bujar dhe bamirës.”*

Secili në ditët e sotme duhet të përpiqet ta përjetojë këtë moral të lartë me aq sa ka mundësi, qoftë edhe në sajë të sakrificave të vogla që mund të bëjë duke privuar nga rehatia personale, zbukurimi i shtëpisë dhe shpenzimet e përditshme. Gjendja në të cilën gjenden nevojtarët, të shtypurit dhe të skamurit përbëjnë

një tablo të mjaftueshme për personat që kanë mundësi të ndihmojnë të tjerët.

### **Kopracia të verbon!**

Për të mundur të bëhesh një dhurues dhe bamirës i vërtetë është kusht të jetosh një jetë brenda konsistencës së ihsanit, pra të jetosh një jetë adhurimi si të jesh duke e parë Allahun. Të shohësh fuqinë dhe madhështinë hyjnore në çdo vend dhe çdo herë është e varur me faktin se sa i çelur është syri i zemrës. Të arrish të bëhesh një bujar i vërtetë është e domosdoshme ndjenja e besimit të shëndoshë që do t'i mundësojë besimtarit që ta ndjejë thellë në shpirt që çdo dhurim i kryer do ta shohë edhe në ahiret.

Me të vërtetë që kopracia e verbon zemrën përballë vdekjes që është fundi i kësaj jete dhe asaj që do të ndodh pas vdekjes dhe është njëkohësisht një shfaqje e tmershme e mosmirënjohjes ndaj zotit që ka krijuar gjithçka për t'ua servirur njerëzve.


Zoti ynë! Mos na ua privo zemrave tona eks-tazën e besimit, shpirttrave tanë harenë e bujarisë dhe ndëgjegjes sonë prehjen e dhurimit!

### **Amin...**

**Dipnotlar:** 1) Bkz. el-Bakara, 219. 2) Bkz. el-Îsrâ, 27.



## Sigurimet bashkëkohore dhe qëndrimi i sheriatit Islam ndaj tyre



**K**ur i kthehemi historikun të zanafillës së sigurimit do të shohim se ky daton që nga shekulli XVI, ku sigurimi vije në shprehje për shkak të paraqitjes së rreziqeve dhe dëmeve që i kanoseshin anijeve që ishin të mbushura përplot me mallra të llo-llojshëm. Ky lloj i sigurimit për herë të parë paraqitet në Lomabardia aty ka viti 1182, e më pas përhapet edhe nëpër shumë vende evropiane.

Me kalimin e viteve sigurimi zhvillohet dhe kalon nëpër faza të ndryshme, se në fillim qëllimi parësor ishte ndihma humanitare, mirëpo më vonë merr formën komerciale.

Ndërsa në botën islame sigurimi nuk është njohur derisa juristi i njohur hanefit Ibn Abidin<sup>1</sup> jep fetva se llojet e tilla të sigurimit janë të ndaluara.<sup>2</sup>

### Përkufizimi i sigurimit:

Rreth përkufizimit të sigurimit dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme dhe përkufizime të ndryshme. Njëri prej

1. Ky është një fekih i njohur hanefit, autor i shumë librave, si libër më i njohur i tij është "Reddul-muhtar alad-derril-muhtar" është lindur në vitin 1198 hixhri (1784 miladi) ndërsa ka vdekur në vitin 1252 hixhri (1836 miladi).

2. Se'adi Ebu Xhejb «Et-teminu bejne-l-hadhri vel ibahati», boton «Darul-Fikri». Liban, 1403 h.\ 1983 m. fq.12

përkufizimeve është ky: "Akti-marrëveshja që e detyron sigrueruin për t'i kompensuar dëmet që i janë shkaktuar të sigruarit në bazë të kushteve dhe marrëveshjes së bërë në mes sigrueruit dhe të sigruarit"<sup>3</sup>.

Të gjithë juristët janë të mendimit se si kushte që duhet domos t'i plotësoj sigurimi janë:

1. Ekzistimi i vendit ku bëhet akti i sigurimit,
2. Që të jetë oferta dhe pranimi nga të dy palët,
3. Që një pjesë të pagesës të bëjë i siguruari tek sigruerisi.

### Llojet e sigurimit:

Sigurimi në fillim ndahet në dy grupe të mëdha:

#### a. Sigurimi sipas përmbajtjes.

Ky lloj i sigurimit ndahet në:

1. Sigurimi për shkak të dëmeve,
2. Sigurimi i personave,
3. Sigurimi personal,
4. Sigurimi social.

3. Se'adi Ebu Xhejb «Et-teminu bejne-l-hadhri vel ibahati», boton «Darul-Fikri». Liban, 1403 h.\ 1983 m. fq. 15. Krahaso: Dr. Vehbete Zuhajli «El-Fikhul Islamijju ve edil-letuhu», boton «Darul Fikri» Damask, 1418 h.\ 1997 m. fq.3420

#### b. Sigurimi sipas formës.

Ky lloj i sigurimit ndahet në:

1. Sigurimi kooperativë apo reciprok
2. Sigurimi përfitues.

#### Qëndrimi i sheriatit islam ndaj këtyre llojeve të sigurimit:

Juristët islam që të gjithë janë unanim se lloj i sigurimit kooperativë është i lejuar dhe i ligjësuar sipas sheriatit islam. Arsyeja e lejimit të këtij lloji të sigurimit është se ky lloj i sigurimit bënë pjesë grupin e marrëveshjeve kooperuese-humanitare që u bëhet atyre që janë të dëmtuar.

Ky lloj i sigurimit sot është prezent edhe në shumë vende islame.

Gjithashtu juristet islam janë të mendimit se sigurimi social lejohet si dhe sigurimi shtetëror që përkujdeset për fondacionin e pensioneve është i lejuar<sup>4</sup>.

Ndërsa sa i përket sigurimit përfitues dijetarët ndajnë mendime të ndryshme: shumica e

4. Dr. Muhammed Sheukijj el-Fenxherijj, «El-Islamu vet-Te'minu», boton «Alemul Kutub» Kahiro, 1979, fq. 16. Krahaso: Dr. Vehbete Zuhajli «El-Fikhul Islamijju ve edil-letuhu» boton «Darul Fikr», Damask 1418h\ 1997 m. fq.3422.



dijetareve janë të mendimit se është rrespsisht e ndaluar.

Juristet që mendojnë se sigurimi përfitues është i ndaluara e arsyetojnë mendimin e tyre duke e mbështetur në këto argumente:

1. Akti i marrëveshjes së këtij lloji të sigurimit është një lloj i shitblerjes me mashtrim, e që dihet se ky lloje shitblerjes është i ndaluar në të drejtën islame.

2. Në këtë lloj të sigurimit përfshihet kamata.

3. Ky akt i sigurimit është i ngjashëm me komorin, ngase në këtë lloj të sigurimit njëra palë dëmtohet.

4. Me këtë akt shfrytëzohet pa të drejtë e drejta e tjetrit.

Ka prej juristëve myslimanë që janë të mendimit se ky lloj i sigurimit është tërësisht i lejuar me kusht që në këtë akt të mos ketë përfshirje të kamatës. Këta mendimin e tyre e mbështesin në këto fakte:

1. Mbështeten në rregullën bazë të sheriatit islam: "Në bazë çdo gjë është e lejuar". Këta duke u bazuar në këtë arrijnë deri të konkludimi se sigurimi përfitues është i lejuar përderisa nuk përfshihet në të kamata.

2. Sigurimi mund të bëhet analogji me aktin e marrëveshjes për miqësim dhe trashëgimi

(**عقد الموالاة**)<sup>1</sup>, e tilla marrëveshje sipas hanefitëve është e lejuar dhe e pranuar në sheriatin islam.<sup>2</sup>

3. Sigurimi ka mundësi të bëhet kijas (analogji) me marrëveshjen e bashkëpjesëmarrjes në fitim (**المصاربة**)<sup>3</sup>.

4. Ekziston mundësia e bërjes analogji në mes të sigurimit dhe kompensimit për mbyjtje (**العاقلة**).

5. Të bërit analogji sigurimin në depozitë (**الإيداع**).

6. Se sigurimi është në interesin e përgjithshëm dhe duke u bazuar në këtë i tilli duhet të

1. Ky lloj akti i njohur si (**عقود الموالاة**) sipas hanefiteve është: «Kur bëhet marrëveshje në mes dy personave kur pronari i pasurisë i thotë personit tjetër se nëse unë bëjë ndonjë gabim ti do të paguash dëmin tim e kur të vdes ti do të trshëosh pasurinë time». Këtë lloj marrëveshje vetëm hanefitet e konsiderojnë të lejuar ndërsa tri medh>hebet tjera nuk e pranojnë dhe e kundërshtojnë të tillën marrëveshje.

2. Ebi Fadel Hani el-Hadidi el-Malikij el-Iskenderij «Et-Te'minu envauhul Muaasireti», boton «darul asamai» Damask 1417 h/1997m. fq. 79.

3. Me shprehjen (**مبارضا**) në të drejtën e -lam nënkuptohet marrveshja e bërë në mes pronarit të pasurisë i cili i ka dhënë pasuri tjetrit që me atë pasuri të bëjë tregti dhe që fitimin ta e ndajnë bashkë.

4. Se'adi Ebu Xhejb «Et-teminu bejne-l-hadhri vel ibahati», boton «Darul-Fikri». Liban, 1403 h. \ 1983 m. fq. 55-56. Karahaso: Dr. Muhammed Revas Kal'axhij dhe Dr. Hamid Sadik Kunejbi, «Mu'xhem lugatul fukahai arebijun-inklizijun», boton «Darun-Nefais» Bejrut 1408 h. \ 1988m. fq.434. Poashtu krahaso: Se'adi Ebu Xhejb «El-Kamusal-Fikhijju Lugaten ve Istilahen» boton «Darul-Fikri» Damask 1429h \ 1998m. fq. 222.

konsiderohet i lejuar.

7. Duke u bazuar në burimin e sheriatit «e drejta zakonore» (**العرف**) sigurimi konsiderohet vepër e lejuar në të drejtën islame.

8. Të bërit krahasim sigurimin me aktin e marrëveshjes për përkujdesjen e mallit të panjohur (**كفالة المجهول**)<sup>5</sup>.

9. Të bërit analogji në marrëveshjen e të bërit roje dhe sigurimit (**عقد الحراسة**)<sup>6</sup>.

10. Sigurimi mund të krahasohet (kijas) edhe me çështjen e garantimit të rrugës nga rreziqet që mund t'i kanosen udhëtarit (**ضمان خطر الطريق**)<sup>7</sup>.

### Sqarimi i mospërputhjes dhe divergjencave ne mes të këtyre dijetarëve:

Duke i analizuar divergjencat e dijetarëve shohim se dijetarët që mendojnë se sigurimi përfitues është i ndaluar iu përgjigjen atyre që mendojnë se është i lejuar duke ua kundërshtuar argumentet e tyre si:

5. Me këtë kuptohet ajo marrëveshje kur dikush i siguron dikujt për ndonjë mall të panjohur dhe se i tilli mall kur kërkohet duhet ta e sjell ai i cili e ka marrë përgjegjësin për përkujdesjen e tij.

6. po aty

7. Sipas hanefitëve nëse dikush i thotë d - kujt se shko kah kjo rrugë se është e sigurt e që nëse të godet diçka unë garantoj për këtë. Po qe se ndodhë që udhëtari pëson diçka atëherë garantuesi duhet t'i kompensoj dëmet që e kanë goditur.

a. Të bazuarit në atë se ky lloj i sigurimit është i lejuar duke u bërë analogji në aktin e marrëveshjes për miqësim dhe trashëgimi është analogji e papranuar dhe tërësisht e refuzuar për këto shkaqe:

1. Në aktin e marrëveshjes për miqësim dhe trashëgimi përgjegjësia është reciproke, e që kjo nuk ekziston të sigurimi përfitues.

2. Po ashtu në këtë akt të miqësimin dhe trashëgimisë synimi parësor është miqësimi dhe ndihma reciproke, ndërsa të sigurimi përfitues kjo fare nuk ekziston.

b. Të bërit analogji të këtij sigurimi me garantimin nga rreziket ne rrugë është i papranuar për të vetmen arsye se të sigurimi përfitues nuk ka as një element të garantim ashtu si e kërkojnë ligjet e jurisprudencës islame<sup>1</sup>.

c. Të bërit analogji në mes të sigurimit përfitues dhe marrëveshjes për bashkëpjesëmarrje në fitim është analogji e papranuar për këto shkaqe:

1. nëse ndodh që pranuari i pasurisë vdesë në aktin për marrëveshje bashkëpjesëmarrjes pasurinë e trashëgojnë trashëgimtarët, ndërsa kjo nuk ndodhë në aktin e sigurimit përfitues për shkak se pasuria nuk u jepet trashëgimtarëve por atyre që i ka përcaktuar i siguruari.

2. pasuria në aktin e marrëveshjes për bashkëpjesëmarrje

1. Shkaqet që sjellin në veprim aktin e garantimit janë të shumta, e ne po i përmendim vetëm këtë: të bërit shkak për dëmtim-shkatërrim: garantimi vije në shprehje atëherë kur ai që bëhet shkaktar për tu dëmtuar tjetri, si p.sh. nëse dikush e hedh diçka në rrugë dhe me të i bën dëm tjetrit. Në këtë rast dëmtuesi duhet t'i kompensojë dëmet e shkaktuar. Ndërsa të sigurimi nuk gjejmë atë se dëmtuesi është shkaktar që të dëmtohet dikush nga i siguruari.

në fitim është pronë e pronarit e jo e atij që punon apo tregton me atë pasuri, kurse në aktin e sigurimit përfitues vlera e pasurisë që i jepet siguruesit ajo aty për aty bëhet pronë legjitime e siguruesit.

ç. Analogjia në mes kompensimit për mbytje dhe sigurimit përfitues është i pa bazë për këto shkaqe:

1. kur ndodh që mbytësi është i varfër nuk paguan asgjë për kompensim ngase nuk ka mundësi, ndërsa të sigurimi përfitues ky lehtësim nuk vije në shprehje dhe se mbytësi edhe nëse është i varfër duhet doemos të bëjë pagesën e kompensimit të dëmit.

2. Arsyeja e kompensimit për mbytje është ndihma dhe përkrahja e të dëmtuarit, ndërsa të sigurimi përfitues është përfitimi i siguruesit.

d. Të bërit analogji në mes sigurimit përfitues dhe marrëveshjes në aktin e të bërit roje është i pa bazë për shkak se të bërit roje si qëllim parësor e ka ruajtjen dhe mbrojtjen e mallit dhe se roja merr shpërblimin për shkak të angazhimit të tij, ndërsa të sigurimi përfitues kompensimi bëhet nëse ndodh dëmi e jo për shkak se e ruan dhe përkujdeset për pasurinë.

e. Të mbështeturit në rregullin që ka të bëjë me rezonimin juridik të bazuar në interesin e përgjithshëm është i paligjshëm për shkak se të sigurimi përfitues nuk është për qëllim ndihma reciproke por është përfitimi.

ë. Të bërit analogji në mes të depozitimit të pasurisë dhe sigurimit përfitues është analogji e refuzuar për arsye se malli i lenë në përkujdesje dikujt nuk bëhet sigurimi nga vdekja, dje-

gia e të ngjashme, ndërsa të sigurimi përfitues bëhet kompensimi edhe nëse malli është shkatërruar nga djegia etj.

f. Të bazuarit në atë se sigurimi është prej nevojave të jashtëzakonshme është mendim i papranuar kur dihet fare mirë se kjo rregull vije në shprehje atëherë kur mbyllen të gjitha mundësit dhe zgjidhjet, e që në këtë rast kjo nuk është e evidente.

g. Të mbështeturit në urf (e drejta zakonore) se sigurimi përfitues është i lejuar konsiderohet gabim, ngase nuk plotësohen kushtet e duhura për tu konsideruar ky lloj sigurimi si një lloj urfi- e drejt zakonore.

j. Bërja analogji në mes të sigurimit përfitues dhe aktit të marrëveshjes për përkujdesjen e mallit të panjohur është i papranuar për arsye se në marrëveshjen për përkujdesjen e mallit të panjohur synimi kryesor është përkrahja kooperative dhe largimi i stërngarkesave nga njerëzit, ndërsa sigurimi përfitues e bënë kompensimin vetëm nëse ndodh dëmi.

### **Mendimi mbizotërues rreth kësaj çështje:**

Në kongresin për dhënien e fetvave me qendër në Mekke me 10. shaban të vitit 1938 h. që të gjithë juristet myslimanë përveç Shejh Mustafa Zerkait ishin të mendimit se sigurimi kooperativë është i lejuar ndërsa sigurimi përfitues me të gjitha llojet e veta i ndaluar. Të gjithë këta juristë myslimanë përveç tjerash mendimin e tyre e mbrojtën duke e arsyetuar kështu:

a. Dijetarët të cilët mbrojnë mendimin se sigurimi përfitues me të gjitha llojet e veta është i ndaluar mbështetën në tekste kur'anore dhe hadithe, ndërsa

ata që mundohen ta arsyetojnë mendimin e tyre se sigurimi përfitues është i lejuar mbështetën në analogji dhe në ixhtihad. Andaj mbështetja në tekste është mbizotëruese në argumentim.

b. Ata që konsiderojnë sigurimin përfitues të lejuar mbështetën në atë se ky sigurim e ka bazën në kuptimin universal të teksteve (ajeteve dhe haditheve) që flasin për ndihmën kooperative-reciproke. E që në thelb dihet se ky lloj i sigurimit ka si synim kryesor eksploatimin e klientit.

c. Ata që e lejojnë këtë lloj të sigurimit mbështetën në komentet e teksteve, ndërsa ata që e ndalojnë mbështetën në vetë tekstet. Andaj është shumë e qartë se ekziston dallim në mes atij<sup>1</sup>.

Pra duke i shikuar mendimet e dijetarëve vijmë në përfundim se mendimi më i pranuar dhe mbizotërues është se sigurimi përfitues me të gjitha llojet e tij është i ndaluar në sheriatin islam.

Po ashtu është e domosdoshme të përmendim edhe atë se për çfarë arsye shumica e juristëve myslimanë janë të mendimit se sigurimi kooperativë mund të aplikohet në shoqërinë islame janë disa veçorit që këtë lloj të sigurimit e dallojnë nga sigurimi përfitues. Këto veçori janë me sa vijon:

1. Sigurimi kooperativë si synim e ka përkrahjen dhe ndihmën reciproke për të gjithë pjesëmarrësit ngase në këtë sigurim kanë dobi të dy palët kontraktuese (i siguruari dhe siguruari).

2. Ndryshimi i vlerës së pasurisë në pjesëmarrje duke shtuar apo pakësuar varësisht prej dëmeve të ndodhura gjatë kohë kontraktuese.

3. Vënia në funksion e ndihmës dhe përkrahjes, ku kompensimi u bëhet dëmeve të shkaktuar tërësisht apo pjesërisht.

4. U kthehet investueseve vlera e pasurisë në përpjesëtim me pjesëmarrje.

5. Të qenit e barabartë mundësia e votimit pavarësisht me sasinë e vlerës së pasurisë në pjesëmarrje<sup>2</sup>.

Duke analizuar këto veçori na del në pah se sigurimi kooperativë me të gjitha llojet e tij është i vetmi sigurim i lejuar në sheriatin islam.

#### **Përfundim:**

Nga e gjithë ajo që përmendëm më lart del në pah ajo se ne jetojmë në një kohë kur domos duhet të jetë në zbatim institucioni i sigurimit, andaj ky lloj i sigurimit duhet të jete në përputhje me parimet dhe rregullat e sheriatit. Andaj për tu zbatuar ky institucion në shoqërinë islame është e domosdoshme tu nënshtrohet këtyre konditave:

1. Që sigurimi shtetëror tu mundësoj punëtoreve që të kenë pasurinë e siguar dhe të mbrojtur nga vjedhja, eksploa-

2. Prof. Dr. Vehbete Zuhajli «Akduh Te'mini Ed-Davabitush-Sheri'ijetu lisuveri ve ukudit-Te'mini alel hajati ve iadetut-Te'mini», boton «Darul Mektebijju» Damsk, 1414h. fq. 21-22.



timit e të ngjashme.

2. Që të jetë sigurimi shtetëror për kategorinë e varfër si garanci për tu siguar atyre nevojat e domosdoshme të jetës.

3. Që sigurimi shtetëror të përkujdeset për kategorinë e shoqërisë që janë me të meta qofshin ato fizike apo psikike, e që të tillët kanë nevojë për përkujdesje.

4. Që shteti tu siguroj udhëtimin njerëzve, me qëllim që njerëzit të jenë të sigurt dhe të qetë në udhëtimet e tyre.

5. Që shteti të kujdeset për t'u ndihmuar atyre njerëzve që kanë pësuar nga ndonjë katastrofë duke humbur pasurinë e tyre.

6. Që shteti të kujdeset për të varfëritë dhe gjendjen e tyre posaçërisht në kohët e krizës financiare.

7. Që shteti të përkujdeset për balancimin ekonomik në shoqëri duke iu ndihmuar më së shumti atyre që janë më të nevojshëm.

1. Se'adi Ebu Xhejb «Et-teminu bejne-l-hadhri vel ibahati», boton «Darul-Fikri». Liban, 1403 h. \ 1983 m. Fq. 77-86

## Haxhi Sheh Muhamed Shaban Efendi Domnori

(1868 - 1934)

**H**axhi Sheh Muhamed Shaban Efendi Domnori ka lindur në lagjen Ajasëm të qytetit të Shkodrës në vitin 1868.

Që në fëmijëri të hershme ndoqi mejtepin e lagjes e më pas kreu shkollën "Ruzhdije", kreu medresenë e Qafës dhe vazhdoi studimet si autodidakt duke bërë një punë të madhe për lartësimin shpirtëror dhe kulturor. Familjarët kujtojnë se njëri nga hoxhët që e mësonte djaloshin ri, duke

parë zellin e vullnetin e tij në punë, pat thënë: *"Zoti e ruejtë, ky fëmijë ka me ecë përpara, ky ta merr fjalën nga goja gjatë shpjegimit të Kur'anit"*.<sup>1</sup>

Që i ri veshi petkun fetar dhe shërbeu si imam në xhami të ndryshme e më vonë në xhaminë e Selvisë në Pazar të Vjetër.

Shaban Efendiu ishte i dhënë pas studimeve dhe meditimeve. Ai udhëhoq nga porositë e Profetit a.s. se: *"Dijetarët shpirtëror të fesë me të vërtetë janë trashëgimtarët më të mirë të profetëve, e profetët nuk lanë trashëgim të holla e pare, por lanë trashëgim diturinë: pra, kush ka marrë dijen, ka marrë pjesën më të mirë e më të dobishme"*. E Shaban Efendiu qe njëri nga ata prijës që iu përvesh me vullnet të pashoq e me bindje të thellë përvetësimit të diturisë të trashëguar nga profetët e lartë, gjë që i shërbeu ngritjes e formimit shpirtëror të tij. Ky lartësim shpirtëror kaloi në tri shkallë: pastrimi fizik, reformimi mendor dhe pastrimi e edukimi moral. Një trup i shëndoshë i aftë për punë të mbara, një mendje e ndritur me dituritë më të larta kanë nevojë dhe kusht të domosdoshëm

një zemër të pastër, një formimin moral të pastër. Bindjet e larta morale, zemra e ushqyer nga morali i lartë udhëheq e drejton mendjen e ndritur dhe të gjitha fuqitë fizike të njeriut drejt një veprimtarie në përputhje me mësimet e Kur'anit të madhërueshëm dhe traditën e shquar profetike. I udhëhequr nga këto parime të larta, Shaban Efendiu që në rininë e vet u fut në një luftë të pandërprerë me vetveten kundër veseve e pasioneve të ulta, që nxisin fuqitë trupore të qenies njerëzore, kundër epsheve që e shtyjnë qenien kundër arsyes dhe bindjeve morale. Kështu shkallë shkallë ai u bë një shebull i përkryer i një njeriu me zemër të pastër, larg interesave materiale, gjë që bëri të mundur të lulëzojë tek ai drita e virtytit e të hidhet me entuziazëm të zjarrtë në lartësimin e botës së vet shpirtërore. Kështu ai u pajis me me forca shpirtërore të paepura për të përballuar vështirësitë e jetës. Në këtë shkallë diturie shpirti i tij u lartësua nga drita hyjnore dhe iu përkushtua me tërë qenien dhe shpirtin e tij adhurimit të të madhit Zot. Të gjithë bashkëkohësit, miqtë që e kanë njohur, kanë dalluar qar-

*"Dijetarët shpirtëror të fesë me të vërtetë janë trashëgimtarët më të mirë të profetëve, e profetët nuk lanë trashëgim të holla e pare, por lanë trashëgim diturinë: pra, kush ka marrë dijen, ka marrë pjesën më të mirë e më të dobishme"*

1. Haxhi Fiqiri Sakti (Mani), "Si lindi T-xhanizmi" në Shqipëri", shënime e kujtime, dorëshkrim, 11 faqe.

të se në zemrën e tij kishte një dashuri të zjarrtë për Zotin e mëshirshëm, dashuri pa masë e kufi, dashuri e pastër, e kulluar, e lartë, e shenjtë. E nuk është aspak rastësi që hirësia e tij Haxhi Vehbi Dibra, në ceremoninë e varrimit, kur po i këndonte telkinen Shaban Efendi Domnori, mes tjerash tha: *“Ti qe mbushë plot me shije shpirtnore e me njohuni hyjnore; ti qe sot je bashkue me atë kategori shenjtësh që quhen të afërt (mukar-rebine) e me atë grup qi kanë konviksion të vërtetë (ehli-hak-ki jekin), me qenë se mbi ty ka shkrep dielli i msheftësinave të jetës tranzitore (berzah)...”*.<sup>1</sup>

Në këtë mënyrë Shaban Efendi Domnori duke ngritur shkallët e diturisë, u bë një shembull i ndritur për besimtarët islamë, tek të cilët ndikoi fuqishëm në shërimin e sëmundjeve morale njerëzore, që janë shoqëruese të pashmangshme të njeriut.

Dijetarët e fesë islame që s’i ndahen së vërtetës asnjëherë s’kanë për të munguar.

Kjo është një nga mirësitë e panumërta që Zoti i madhërueshëm i ka dhuruar bashkësisë islame. Kjo vërtetohet edhe nga tradita profetike: *“Deri në ditën e kiametit kurrë nuk kanë për të munguar një grup dijetarësh prej ymetit tim që kanë për të qenë përkrahësit e së vërtetës”*.<sup>2</sup>

Shaban Efendi Domnori, nisur nga qëllimi i lartë i fesë islame për lartësimin shpirtëror dhe përsosmërinë e njeriut, punoi tërë jetën për t’i pajisur njerëzit me sjellje fisnike, me

1. Hasan Tahsini, Shtyllat e tarikatit “Tixhani”, Shtypshkronja “Gutenberg”, Tiranë 1941, XIX, fq. 12

2. Po aty.

cilësi morale të larta e me virtyte të bukura, luftoi për t’i pastruar zemrat e për t’i ndriçuar shpirtat e besimtarëve. Kjo bëri që tek ai besimtarët të kërkonin mbështetje, të kërkonin lidhje shpirtërore. Natyrisht në këto kushte Shaban Efendi e ndjente veten gjithnjë në kërkim, gjithnjë në rrugën e përpjekjeve për t’iu afruar dritës shpirtërore, dashurisë së amshueshme, diturisë për Zotin e Madhërueshëm.

Miku edhe pasuesi i tij, Hasan Tahsini (Haveriku) shkruan: *“Kjo dëshirë e zjarrtë i dha zemër e vullnet me u nisë për në rrugën e gjatë por të bekue-me, për të kryer detyrën e naltë të HAXHIT e për të vizitue vendet e shenjta islame, tokën e shenjtë të Qabes, ku ka lemë dhe është rritë dhe ku ka krye misonin profetik i dashtuni i Zotit, Hazereti Muhamedi Alejhiselam...”*.<sup>3</sup>

Sipas kujtimit të familjarëve të Shaban Efendisë tregohet se ai zotëri ka shkuar në haxhillëk disa herë: për të kryer detyrën e vet, herën e dytë për dajën, në vendet e shenjta u takua me shumë njerëz të ditur dhe me shehlerë të nderuar. Me këtë rast solli në Shkodër dhe përhapit idetë e tarikatit “Helveti”. Herën e tretë shkoi për hallën e vet dhe me këtë rast u ndikua nga idetë e tarikatit “Nakshibendi”. Ai nuk pati rahati “deri sa të çonte në vend vullnetin e të Madhit Zot”, prandaj së bashku me shokët e vet, dijetarët e nderuar shkodranë Haxhi Hafiz Isuf Kelmendi dhe Haxhi Hafiz Isuf Karakaçi, shkoi përsëri në haxh, për herë të katërt. *“Kur ka shkuar në Medine, ku pushon trupi i pastër*

3. Hasan Tahsini, po aty, kapitulli “Tixhaniszm né Shqipëri”, fq. 28-29.

*i të dashtunit të Zotit, ka takue Shejhun e Tixhanisë, Sejjid Abdul Kadër Minhanxhinë, të cilit i asht dorëzue deroish i thjeshtë, në këtë sekt asht ba sheh dhe kur u kthye në Shqipni, filloi të përhapë këtë dritë të Madhnueshme”*.<sup>4</sup>

Studiuesi Hamdi Bushati në librin “Shkodra dhe motet” mes tjerash shkruan për Tixhanitë e për rolin që luajti në përhapjen e këtij tarikati Sheh Shaban Efendi. Ai mes tjerash thotë: *“Në vitin 1920 doli në skenë tarikati “Tixhani”, i udhëhequr nga Haxhi Shaban Domnori, një nga teologët e mistikët ma të njoftun në rrethin e hoxhallarëve të Shkodrës, ndoshta të gjithë Shqipnisë. Haxhi Shabani ka qenë dishepull i Haxhi Hasan Sheh Shamisë. Mund të themi se edhe Haxhi Shabani qe natyrë reformatore e toleranti brenda kufijve të fesë islame. Ai nuk qe fanatik, predikoi gjithnjë me kurajo e autoritet. Në popullin e Shkodrës Haxhi Shaban Domnori gëzoi respekt të veçantë. Në fillim nisi të drejtojë tarikatit “Tixhani” në formë klandestine. Në atë kohë banohte në lagjen “Ajasëm”, ku edhe formoi të parin kand (Zavie) për muridët e rrethit të tij. Me kohë udhëzimet e tij patën jehonë të madhe në shtresat e ndryshme të popullatës. Me ndihmat e anëtarëve të rrethit Haxhi Shabani bleu një shtëpi në lagjen “Ndocej”. Këtu ai themeloi teqen e Tixhanive. Për deri sa jetoi, aty vazhdoi e ushtrojë lutjet e ceremonitë fetare të tarikatit të tij. ...”*.<sup>5</sup>

Haxhi Shabani pat shumë

4. Hasan Tahsini, vepër e cituar, fq. 29.

5. Handi Bushati, vepër e cituar, paragrafi që flet për teqet në Shkodër, Tarikati “Tixhani”, fq. 601.

ndjekës të tarikatit "Tixhani", falë autoritetit të tij si teolog i përsosur dhe dijetar kompetent e autoritar. Ai u bë një kumtues i vërtetë i mësimëve të Kur'anit famëlartë. Ndër pasuesit e tij më të zellshëm mund të përmendim Haxhi Muhamet Bekteshin, Sheh Qazim Hoxhën, Sheh Xhemal Alibalin, Hasan Tahsinin, Shefqet Mukën e plot dijetarë të tjerë të shquar, hoxhallarë e intelektualë të nderuar.

Haxhi Sheh Muhamed Shaban Efendi Domnori pat miqësi të ngushtë edhe me dijetarë të tjerë islamë brenda e jashtë vendit. Kishte lidhje, miqësi dhe korrespondencë me Hafiz Vehbi Dibrën, Hafiz Ali Korçën e me shehlerë të nderuar të Beratit e të Vlorës.

Gjatë vizitave të tij në Haxhi ai u njoh me shumë dijetarë nga Turqia, Persia, India e

vende tjera, me të cilët pat një korrespondencë të gjerë. Me ta pati edhe shkëmbime literature. Zotëronte përveç gjuhës turke dhe arabe edhe persishten e gjuhën kineze, të cilat siç dëshmojnë trashëgimtarët i mësoi si autodidakt. Për fat të keq e gjithë biblioteka shumë e pasur në gjuhë të huaja dhe dokumentacioni i shumtë e epistolari i tij u konfiskuan plotësisht gjatë përndjekjeve të diktaturës komuniste.

Përveç veprimtarisë publike si hoxhë dhe prijës i ditur, ai qe organizator i përkushtuar për themelimin dhe organizimin e tarikatit "Tixhani" në Shkodër e më gjerë. Risitë apo përpjekjet në rrugën e misticizmit apo të tarikateve tjera lidhej me një traditë konservatore, që nuk bënte lëshime. Duhet të ketë qenë autoriteti i padiskutueshëm dhe përkushtimi i thellë në rrugën e mësimëve kuranore dhe të hadithevë të Profetit a.s., që e lejuan Sheh Shaban Domnorin që jo vetëm të vepronte, por edhe të zgjeronte veprimtarinë e vet duke shtuar rrethin e pasuesve të tij, me besimtarë të thjeshtë, por edhe me personalitetet më të spikatura të fesë islame në Shkodër.

Haxhi Shabani i këshillonte besimtarët që të shqyrtonin mendimet, sjelljet dhe veprimet e tyre. Njeriu bën gabime në mendimet e në veprimet e veta, herë herë me qëllim, herë pa dashje e herë nga pakujdesia. Për këtë arsye njeriu e ka për detyrë të kërkojë falje për gabimet e mëkatet e ndryshme. Kjo lidhet me pastrimin shpirtëror, me pastrimin e ndërgjegjes, me qetësimin e mendjes, me

njohjen e vetvetes, me krijimin e marrëdhënieve të drejta me vetveten, me rrethin e njerëzve me të cilët kemi kontakt e me vetë Perëndinë Shpirtmadh. Sa i qetë ndjehet njeriu që ka bërë një gabim apo faj, kur e kupton këtë, kur kërkon ndjesë për mëkatin, kur përpiqet të mos e përsërisë më. Nga e gjithë kjo brengë e thellë që e kapërthen, nga ajo gjendje tensioni nervor e shpirtëror, pas pendimit e kërimit të mëshirës nga i Madhi Zot, ai qetësohet, zbutet, lehtësohet dhe e ndjen veten të barabartë e të aftë për të vazhduar punët e mira, rrugën e drejtë e të përcaktuar nga Zoti i Plotfuqishëm.

Haxhi Shabani ishte mjeshtër në parashtrimin e ajeteve kuranore, të haditheve të profetit e sidomos në komentimin e tyre me shembuj shumë interesantë nga jeta e përditshme e sahatëve të Profetit dhe e besimtarëve islamë. Ai dinte të jepte argumente bindëse me një logjikë të mprehtë e ndjenjë të thellë mëshire e dashamirësie të Zotit të Madhëruar për njeriun. E besimtarët, pasues të shumtë të Haxhi Shabanit, e dëgjonin me interes dhe respekt. Fjalët e tij ishin një balsam për zemrat e besimtarëve, që nga analizat dhe shpjegimet e Shehut të tyre gjenin ngrohtësinë e qetësinë shpirtërore.

Haxhi Sheh Muhamed Shaban Efendi Domnori ndërroi jetë me 28 dhjetor 1934, ditën e diel dhe u varros në lagjen "Dudas" në Shkodër. Në faljen e xhenazes dhe në përcjelljen për në varreza morën pjesë autoritet fetare e shtetërore, një varg i gjatë hoxhallarësh të Shkodrës dhe prej shumë kra-

*"Deri në ditën e kiametit kurrë nuk kanë për të munguar një grup dijetarësh prej ymetit tim që kanë për të qenë përkrahësit e së vërtetës"*

hinash tjera, qytetarë të panu-  
mërtshkodranë nga rrethinat.  
Telkine e këndoi Eminenca e  
tij, Haxhi Vehbi Dibra, Krye-  
tar i Komunitetit Mysliman të  
Shqipërisë. Fjala e përmort-  
shme e Haxhi Vehbi Dibrës u  
botua në revistën “Zani i Nal-  
të”. Mes tjerash duke cilësuar  
Haxhi Shaban Domnorin, ai  
tha: “... ishte mbushë plot me  
shije shpirtnore e me njohuni  
hyjnore”... “Mbi ty ka shkrep  
dielli i jetës tranzitore”...“O  
Zotni i Shenjtë, që ke mbërri  
në pozitë e nalta të afërsisë  
hyjnore, të pranisë së amshue-  
shme e të udhëheqësisë së  
shenjtë: Vendin tand në jetën  
transitore, në jetën e vorrit, e  
ke të ndritshëm:banimi yt asht  
Parajsa e Perëndisë hyjnore,  
Xheneti Visal.

O Zot, qi shpërndan begati  
shpirtnore: na ban pjesëtarë  
edhe neve në begatitë e asaj  
pozite!”<sup>1</sup>

Po në këtë numër të këtij or-  
gani, u botua edhe një artikull  
i Shefqet Mukës i cili e cilëson  
Haxhi Muhamed Domnorin  
“... një nga mbretit e botës  
shpirtnore...”, ... “... një nga  
hoxhët e mëdhaj, të zotët e të  
virtytshëm qi numron e dallon  
me gisht sot Shkodra”...“Prej  
vargut të hoxhëve vjen e kë-  
putet një ndër ma të mirët prej  
tyne...Haxhi Sheh Shaban Efe-  
ndiu gjithë jetën e vet ç’prej ri-  
nie e deri sod qi dha shpirtë, e  
shkrini në studim e në iradet, e  
sidomos kohët e fundit, si Sheh  
i Tixhanive, e kaloi pothuaj-  
se krejt në ziqër”. Më poshtë  
duke analizuar vlerat e Haxhi  
Shabanit shton se “Ai nuk zë-

vendësohet. Në dituritë fetare  
e në filozofinë islame e sidom-  
os në pjesën e tesavvufit asht  
i pazavendësueshëm, gja të ci-  
lën e pohojnë edhe kolegët e  
dishepujt e tij që la pas vedit”.<sup>2</sup>  
Në numrin që pasoi të revistës  
“Zani i Naltë”, intelektual i  
njohur Ferid Vokopola, botoi  
poezinë “Perëndimi i Shejh  
Shaban Tixhanisë”.<sup>3</sup> Këtë poe-  
zi ua kushton :“Gjurmonjësve  
të udhës së Tixhanisë një dhu-  
ratë miqësore”. Mes tjerash po-  
eti Vokopola tregon se era fryu  
plot thellime dhe shoi lulet, e  
Sheh Shabani ishte një lule që  
tashmë perëndoi. Menjëherë  
autori thotë “S’mund të themi  
perëndoi”, ai “ishte yll i Perë-  
ndisë”, sepse shpirti i tij shkoi  
“drejt për drejt në Paradisë”.  
Sheh Shabani vdiq fizikisht,  
por pas ka lënë një “sheh të  
ditur”, “S’ka ndryshuar formë  
e lëndës,/ Rron “Aji” si shpirt i  
ndritur”.

\* \* \*

S’mund të shuhet Drit’ e Zo-  
tit,

Mbretëron Fuqi e Ti;

Në ndryshon jeta e Motit,

Ngjallet jeta përsëri.

Nga vdekja ka lindun jeta,

Pra të gjallët nuk jesin;

Çdo gjë kthen tek e vërteta:

Besimtarët nuk vdesin...

Ashtu siç e kanë cilësuar  
shumë tjerë (H. Mustaf Suknej,  
Shefqet Muka) Shaban Efendia

2. Shkodrani (Sheuqet Muka), “Rahmet  
pastë”, Zani i Naltë, vepër e cituar, fq. 454.

3. Po aty, nr. 15, fq. 448. Për Sheh Shaban  
Domnorin shih edhe veprën “Në kujtim të  
brezave”, fq. 175- 189.

ishte “Zotni i Zotit në faqen e  
dheut”.

Tarikati “Tixhani”, edhe  
mbas rrebeshit 50-vjeçar ko-  
munist, jetoi sepse zuri vend  
në zemrat e mendjet e njerëzve,  
një nga pasuesit e nderuar të  
këtij tarikati ka qenë edhe Ha-  
xhi Hafiz Sabri Koçi. Mes tje-  
rash Sheh Ismail Aga shkruan:  
“Në udhëheqjen shpirtërore  
të tarikatit “Tixhani” bën pje-  
së edhe kryesori i Komunitet-  
it Mysliman Shqiptar, Haxhi  
Hafiz Sabri Koçi... Në punë  
e tij drejtuese njeh me detaje  
tarikatet islame dhe është një  
këmbëngulës i rreptë në zbatim  
e rrugës së tarikatit, që ata  
të veprojnë brenda kuadrit të  
Bashkësisë Islame”<sup>4</sup>

Edhe sot e kësaj dite ky ta-  
rikat ka plot ndjekës në Shko-  
dër, mes tyre shquhet Haxhi  
Faik Hoxha, ish Myfti i Shkoder-  
rës, Nënkyetar i i Organizatës  
“Drita Hyjnore” të Tarikateve  
në Shqipëri. Kohët e fundit  
u organizua një veprimtari  
shkencore kushtuar Sheh Qa-  
zim Hoxhës, Kryetar i tarikatit  
“Tixhani” për Shqipërinë dhe  
djalit të tij të denjë, Haxhi Faik  
Hoxhës, ish myfti i Shkodrës.  
Materialet e kësaj veprimtarie  
u botuan në një libër. <sup>5</sup>

Ne e përkujtojmë sot Haxhi  
Sheh Shaban Efendi Domno-  
rin, sepse ai lindi në vitin 1868,  
plot 140 vjet më parë, ndërsa  
vdiq në vitin 1934, 75 vjet më  
parë, pra vitin që shkoi kish-  
te 140 vjetorin e lindjes, ndër-  
sa në këtë vit ka 75-vjetorin e  
vdekjes.

4. Sheh Ismail Aga, Tarikati “Saadi”, në  
librin “Vendet e shenjta shqiptare”, Tarika-  
tet”, 1995, fq. 22-23.

5. Organizata “Drita Hyjnore”: “Nderim  
për Sheh Qazim Hoxhën dhe trashëgimtarin  
e denjë të tij Haxhi Sheh Faik Hoxha”,  
Tiranë, 2007.



# NJË SHOQËRI QË DI TË DHUROJË



*“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë që t’i  
pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira!”*

*(Tevbe 103)*



Nëse diku bëhet fjalë për pastrim aty flitet edhe për një ndryshim. Çfarëdo lloj adhurimi që të vëmë re tek myslimanizmi nuk do të mund të shohim dy ditë në të njëjtën nivel.

Psh nëse myslimani falet namazi i sotëm duhet të jetë ndryshe nga ai i djeshmi dhe ai i nesërmi ndryshe nga ai i sotmi. Një mysliman nuk duhet të jetë asnjëherë një pus i pafund dhe i verbër. Ai duhet të jetë përherë si një lum dhe si një det, duhet të rinovohet vazhdimisht, duhet të rrjedhë drejt të përtejmeve.

Nëse myslimani e bën pjesë të jetës së vet këtë rrjedhshmëri nuk ka gjë që nuk do të mund

të arrijë në jetë.

Një hadith i profetit thotë: “Edukohuni dhe etikën e Allahut dhe të dërguarit” E dimë që Zoti është Rahman. Mëshira e Tij ka përfshirë çdo qenie. Një veçori e pashmangshme e mëshirës është “Vehhab” Jep pa kërkuar. Është Xhevad. Nuk pret nga ajo që jep. Është Kerim. Bujaria e Tij s’ka kufi. Ndërkohë që njerëzit kur dëshirojnë dhe kërkojnë nga njëri-tjetri fillojnë e mërzhiten dhe preken. Kurse Allahu zgjerohet për sa kohë që i kërkohet prej Tij. Jep vazhdimisht pasi thesari i Tij është i pafund. Për sa kohë që një besimtar i ka bërë pjesë të vetën këta cilësi të Zotit i ka besuar plotësisht

Atij. I është besuar plotësisht Atij dhe si rrjedhojë ka gjetur edhe çelësin e thesarit. Ajo që e ka çuar besimtarin në një lumturi të tillë është bindja ndaj urdhrit “Jepni” dhe sukcesi në këtë hap të hedhur. Ai që arrin të hedhë një hap të tillë ndien përbrenda një ndjenjë të papërshekueshme. Kjo është pasqyrim i kënaqësisë që ndien një mysliman që dhuron diçka në zemrën e atij që jep. Një ndjenjë e tillë e nxit dhënësin që të japë më tepër. Edhe Allahu vazhdon t’i japë më shumë. Myslmani i ndodhur në një pozicion të tillë është i pastruar plotësisht dhe duke marrë edhe duanë e nevojtarëve të panumërt ka fituar edhe lumturinë e dy botëve.

Mos e mendoni dhënien kaq të thjeshtë pasi nuk është diçka që çdokush e di dhe është i suksesshëm. Çështja e dhënies është një mundësi që e jep Allahu sikurse është namazi, agjërimi apo veshjet e përditshme. Këta janë të tillë që nuk janë në dijëni se kanë zili për gjërat që nuk mund të japin, në zemrat e të cilëve nuk janë zhvilluar ndjenjat e dhembshurisë dhe se nuk mendojnë si do të jenë të nesërmet për ta. Ata nuk dëshirohen në mesin e njerëzve duke qenë se nuk japin as një të miltën e asaj që Allahu u ka dhënë. Duke qenë se e dinë këtë dukuri ata shkatërrojnë edhe botën e ahiretit. Gjithashtu edhe pasuria që u ka dhënë Allahu bllokohet ngaqë këta e pengojnë dhe nuk rrjedh aty ku duhet. Në një kohë të shkurtër sëmundje të tilla si zilia, koprracia, ngurtësia, mosmendimi për të tjerët përhapen në shoqëri duke u kthyer në grumbullime ujërash të zeza.

Ja pra, myslimanizmi ka urdhëruar **“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë që t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira!”** (Tevbe 103) që të mos ketë asnjë ndarje të madhe mes të pasurve dhe të varfërve.

Sadakaja është një pohim vërtetësie e një myslimani. Është një dokument që tregon lidhjen e ngushtë me fenë e tij. Një mysliman që nuk jep zeqatin quhet gënjeshtar. Namazi i

gënjeshtarit nuk pranohet. Gënjeshtria është një cilësi shumë negative. Ndërkohë që namazi e pastron njeriun nga të gjitha këto të këqija. Çfarë namazi fal një njeri që nuk heq dorë nga të këqijat?

Myslimani i cili e llogarit dhe e jep në mënyrë të drejtë zeqatin e tij ka pastruar njëkohësisht edhe pasurinë e tij. Edhe kafshata që ha myslimani nga një pasuri e tillë është një kafshatë e pastër. Si rezultat edhe mendimet dhe ndjenjat e tij janë të pastra. Kjo pasi ai ka menduar edhe për të drejtën që ka i varfëri nga pasuria e tij duke e dhënë atë.

Myslimanizmi është munduar t’i dhurojë njeriut që në fëmijëri ndjenjën e dhënies duke arritur kështu edhe qëllimin e tij të edukojë një shoqëri që di të japë. Psh kur lind një fëmijë mysliman në javën e parë i vihet emri, i pritët floku dhe jepet një sadaka sermi në masën e flokut. Gjithashtu edhe në Bajramin e Ramazanit dhe para faljes së bajramit çdo individ i vetëdijshëm dhe me vullnet të plotë e ka vaxhib t’i japë një të varfëri sadaka-i fitrin.

Myslimanët e kanë jetuar kohën e artë të “dhënies” si në kohën e sahabëve ashtu edhe në periudhën e Perandorisë Osmane.

Sistemet që nuk arrijnë të

edukojnë një brez që di të japë, në një moment bllokohen dhe shpërthejnë.

Sistemet aktuale, duke qenë se nuk janë paqësuar me virtytet madhorë të shoqërisë së sotme, kanë edukuar një brez që **“di të hajë”** dhe jo **“të japë”**

Në çdo pjesë të shoqërisë sonë ka plot dhembje dhe bllokime në masa të mëdha. Zgjidhje e vetme për ta është rikultivimi i virtyteve të larta njerëzore të shoqërisë sonë që janë përpjekur t’i heqin me kohën.

### **Pjesa nga historia / Nëse e ke shumë të nevojshme**

Një mysliman në kohën e Sulltan Fatihut, pasi kishte kërkuar me ditë të tëra një mysliman të varfër për t’i dhënë sadakanë vjetore nuk e kishte gjetur, ndërkohë sadakanë e mbledhur e kishte vendosur në një qese dhe e kishte varur në një pemë mbi të cilën kishte shënuar **“Vëllai im mysliman, Nuk arrita të gjej dikë që t’i jepja zeqatin. Nëse je nevojtar merre këtë pa ngurrim”** Në historinë tonë tregohet se një qese e tillë ka qëndruar në atë pemë për tre muaj me radhë.



## PIKA ELIKSIRI NGA DETI I MESNEVISË

**S**htëpia botuese Progresi ka nderin t'i ofrojë lexuesit shqiptar botimin e saj më të fundit, veprën e titulluar "Pika eliksiri nga deti i Mesnevisë" i autorit të njohur Osman Nuri Topbash.

Njerëzit me botë më të madhe shpirtërore, për të mbërritur në nivele sa më të larta, duhet t'ua hapin qiejve dyert e shpirtit, pasi aty derdhen pasuritë e brendshme mistike. Përndryshe, ata do të zhyten në terrin e verbërisë, ashtu sikurse ka ndodhur me shumë njerëz të zgjuar dhe të përkushtuar.

Për këtë arsye, në skenën e historisë islame shfaqen në mënyrë të herëpashershme grupime mistike, të cilat duke i dhënë më shumë përparësi zemrës, si qendër dashurie dhe besimi, sesa mendjes, nuk lejojnë që një ndërtesë (e cila për t'u mbrojtur nga ndikimet e jashtme ka vetëm muret mbrojtëse) të shembet, por përpiqen

ta përforcojnë e ta stolisin atë.

Ato që janë pjesëmarrës në këtë proces dhe, gjithashtu, ndihen të aftë në planin shpirtëror, fitojnë një pjekuri vlerësimi të situatave të ndryshme, si nga thellësia shpirtërore ashtu edhe nga ajo intelektuale. Kështu, përballë pasioneve dhe vështirësive, ata janë më të mbështetur tek Zoti dhe më rezistentë, sepse tasavufi fillimisht kultivon pëlqimin dhe kuptimin e Vullnetit Hyjnor, si dhe dhuron aftësinë perceptuese të detajeve të "Administratorit Suprem". Ai siguron ngushëllim, plotësim të brendshëm dhe qetësi.

Për këtë arsye, në periudha krizash, grupimet mistike kanë gjetur përkrahje edhe më të fortë. Formula shpirtërore mistike: "**Vështro krijimin nëpërmjet syrit të Krijuesit**" u është bërë dashurindjellëse, strehë dhe prehër i ngrohtë. Ajo ka kultivuar gjerësisht ndjenjën e dhembjes dhe të dialogut ndaj të dobtëve, të dëmtuarve dhe



gjithashtu ndaj atyre që u është bërë padrejtësi.

Kjo e vërtetë bëhet me e dukshme kur ne hedhim një vështrim drejt etapave më të vështira të historisë islame, atyre të invazioneve mongole, të cilat shkatërruan botën islame dhe e dobësuan shoqërinë e saj në përmasa të mëdha. Në atë periudhë, tasavufi u bë një qendër joshjeje. Ai u dhuroi njerëzve strehën dhe ilaçin; ju dha atë që u mungonte: ngushëllimin dhe qetësinë shpirtërore...

Në këto kohë të vështira u shfaqën miqtë e Zotit, si Junus Emre dhe Mevlana Xhelaluddin-i Rumi, të cilët shpërndanë shërim dhe begati. Ndikimi i tyre vazhdon akoma edhe në ditët e sotme.

Në periudhat kur tasavufi zbehet dhe ndikimi i tij në shoqëri bie, fillojnë të shfaqen kriza të thella sociale. Që në shekullin e 19-të filluan të shfaqen tendencat e **“devijimit nga islami”**, ndikimi negativ i të cilave vërehet edhe sot. Njeriu i kohëve tona u është dorëzuar tërësisht thirrjeve të epshit. Atij i është dobësuar jeta shpirtërore edhe më shumë sesa në periudhën e invazioneve mongole, sepse ndihet i pafuqishëm të përballojë trysnisë e botës materiale. E zhytur në vorbullën e imoralitetit, shoqëria që na rrethon ngjan me një kërcu që gjendet në mesin e vërshimeve të lloj-lloj prurjeve; prandaj dhe destinacioni i kësaj shoqërie është i paparashikueshëm. Për t'i rezistuar këtij mjedisi kaotik dhe shumë të rrezikshëm, lind domosdoshmëria e strehimit në limanin e prehjes dhe të qetësisë së tasavvufit.

Arsyet e mësipërme janë ato që e bëjnë autorin e kësaj vepre Osman Nuri Topbashin të mendojë dhe besojë se në kohët tona, situatat e ndryshme që na servir jeta nuk mund të vlerësohen vetëm me syrin e mendjes - cili ndjehet i pushtuar tërësisht nga kthetrat e materies - por vlerësimi i tyre me syrin e zemrës e gjithashtu me urtësinë shpirtërore është një domosdoshmëri jetike. Autori thekson të vërtetën se muslimanët duhet t'u përkushtohen sërish kuptimeve që fshihen tek këshillat plot urtësi dhe shembujt shumë domethënës të miqve të Allahut, si: Bahaeddin Nakshibendi, Mevlana Xhelaluddin Rumi, Abdulkadër Gejlani etj.

Për të përfutur sa më shumë prej këtyre kolo-

sëve të islamit autori Osman Nuri Topbash ka shkruar edhe veprën e njohur **“Një shtambë uji nga kopshti i Mesnevisë”**, ndërsa vlera e veprës së tij të titulluar **“Pika eliksiri nga deti i Mesnevisë”** qëndron në faktin e ridhënies të të njëjtit mesazh: Njerëzimi që përpëllitet në një mijë e një kriza të ndryshme, ka nevojë gjithmonë ta marrë në konsideratë tasavvufin si shërues dhe eliksir për qenien. Nga rreshtat e veprës **“Pika eliksiri nga deti i Mesnevisë”** kuptojmë se autori Osman Nuri Topbash është inkurajuar nga fryma e ngrohtë e shëruese e Mesnevisë. Nga ky këndvështrim, vepra që keni në dorë është si një **“shtambë uji”** e dytë për myslimanët, që janë të etur për qetësi dhe ngrohtësi shpirtërore.

Me këtë vepër autor Osman Nuri Topbash gjen rastin të shpreh konsideratat e tija për veprën e Mesnevisë e cila, me oqeanet e kuptimeve dhe sekreteve që përmban, i ka shërbyer jo vetëm myslimanëve, por mbarë njerëzimit. Kjo vepër është vizatimi me fjalë i shpirtit të njeriut dhe i zbulimit të sekreteve të tij.

Mevlana, në veprën e tij **“Mesnevi”**, ka arritur të zbresë në thellësitë e shpirtit të njeriut, ka dëshmuar me anë të zbulimit të identitetit të tij të vërtetë thelbin e njeriut dhe ka vënë kujën në kërkim të një shpirti që mund të qante për vuajtjet e tij.

Janë shumë të rralla veprat si **“Mesnevi”**, të cilat trajtojnë të vërtetat e misticizimit dhe detajet shpirtërore të njeriut me aq thellësi depërtimi. Temat që janë shumë të vështira për t'u rrokur nga mendimi njerëzor, Mevlana i ka bërë më të kuptueshme me shprehje dhe tregime të urta, duke depërtuar shumë thellë në brendësi të shpirtave të njerëzve të mbërritur.

Zoti ynë bëri të mundur daljen në dritë të këtij libri në gjuhën shqipe - të frymëzuar, së pari, nga oqeani shpirtëror plot urtësi i veprës së Mevlanës, si dhe nga përsiatjet emocionale të autorit Osman Nuri Topbash dhe penës së tij të mirënjohur.

Allahu i pranofte qëllimet tona të sinqerta dhe përpjekjet për realizimin sa më të përsosur të këtyre vepre - që janë letra drejtuar njerëzimit - dhe i bëftë ato dritare shpirtërore, të cilat u ofrojnë shpirtave të lodhur mundësinë e pushimit e të qetësisë. Amin.

## Historiku i xhamisë Boriç i Madh (Vrakë)

**P**o shkruaj shkurtimisht historikun e kësaj xhamie në mënyrë që t'u shërbejë brezave të ardhshëm, ku për këtë historik u jemi mirënjohës pjesëtareve të këtij fshati.

Me ikjen masive të shqiptarëve nga trojet po shqiptare të rrethinave të Tuzit në Malin e Zi, ata u vendosën në fshatrat e Shtojit të vjetër, Shtojit të ri dhe në Boriç të madh. Në atë periudhë në këtë fshat jetonin popullsi me origjinë sllave nga ish Jugosllavia. Me ardhjen e myslimaneve në këtë fshat, sllavet e këtij fshati u shpërngulën dhe shkuan në zonën e Zetes në Mal të Zi. Ardhja e myslimaneve në këto fshatra ka qenë periudha e viteve 1930-1933 dhe ka zgjatur deri në vitin 1936, vit për të cilin, lindi domosdoshmëria për hapjen e një institucioni fetar, ku të kryheshin ritet fetare.

Institucioni fetar u hap në vitin 1936 pikërisht në një dhomë të shtëpisë së Sait Cafit, ku ritet fetare do të kryheshin nga imami Ibrahim Ali Gurakuqi që ishte nga fshati Gurakuq i rrethit Librazhd. Pas shtëpisë së Sait Cafit u vendos që ritet fetare të kryhen në shtëpinë e



Qazim Halilit, dhe në vitin 1941 falë bujarisë dhe devotshmërisë së Jakup Dresheviq dhe Malo Beg Dizdarit, u dhuruan nga 2 dynym tokë secili dhe vendosën që të ndërtojnë këtë xhami me kontributet e tyre në mënyrë që të kryhen ritet fetare në një ambient më të përshtatshëm e cila ndodhet edhe sot po me ato përmasa.

Me ndërtimin e xhamisë imam Ibrahim Aliu punoi shumë me brezin e ri dhe arriti të hapë mejtepin e parë në këtë fshat ku mësuan edhe fëmijët nga fshati Guci e Re. Imam Ibrahim i në këtë mejtepin arriti të krijojë tre grupe ilahish ku ndër ta mund të përmendim: Murat Zyberin, Bajram Ademin, Keto Zekun, Sadik Bishin, Isa Bajrin, Mustaf Bajrin, Kushe Kadrija, Medo Bishin, Sulo Bishin, Hajdar Jakupin, Ramo Kadrin, Omer Sadikun etj.

Imam Ibrahim Aliu qëndroi dhe shërbeu në këtë fshat për 12 vite radhazi deri në vitin 1984 pastaj vazhdoi aktivitetin e tij në zonën e Postribës.

Pas largimit të imamit Ibrahim Aliut detyrën e imamllëkut në këtë fshat e mori imam Zaim Biallaku nga Bjello-Pole e Malit të Zi ky

ishte me një kulturë të lartë Islame dhe punoi me një përkushtim të madh. Imam Zaimi shquhej për pikturë. Ai pikturonte peizazhe nga natyra me dua dhe me ajete Kur'anore, ku shume prej pikturave të tij ndodhen edhe sot në shumë shtëpitë e besimtarëve mysliman.

Imam Zaim Biallaku qëndroi në Boriç të Madh deri në vitin 1956 pastaj ai u zhvendos në fshatin Shtoj i Vjetër. Pas tij detyrën si imam në këtë fshat e mori Imam Haki Halili i cili ishte dhe banor i këtij fshati. Imamllëkun në këtë fshat e vazhdoi deri me mbylljen e plote nga regjimi totalitar në vitin 1967.

Kjo xhami nga regjimi komunist u shfrytëzua fillimisht si depo drithërash me pas si çerdhe dhe më vonë u përdor si kopsht fëmijësh si depo armatimit ku oborrin e xhamisë e fortifikuan nga të gjitha anët me bunkerë.

Me ardhjen e demokracisë në vitin 1991 xhamia u rihap përsëri me kontributin e vetë besimtarëve të fshatit. Pas demokracisë detyrën si imam e filloi Rifat Osmani i emëruar nga Myftinia Shkoder. Rifat Osmani para mbylljes së fesë në vitin 1967 ka shërbyer si imam në fshatin Vilz të Postribës.

Me fillimin e detyrës si imam Rifat Osmani dha një kontribut të madh me kursantët ku ndër ta arritën të dalin imamë dhe të kontribuojnë edhe sot në xhami të ndryshme si Naim



Drijaj, Begator Fikaj, Suad Lekaj etj.

Në këto vite të demokracisë në këtë xhami kanë dhënë kontribut të madh edhe besimtarët ku ndër ta vlen të përmendim kontributin e besimtarit Shaqir Gjeka. Kjo xhami erdhi duke u degraduar nga vitet që mbante në supet e saja dhe u desh të ndërhyhej që të restaurohej. Restaurimi i saj u bë realitet në vitin 2004 me kontributin e vete fshatit dhe disa biznesmenëve nga Shkodra. Imam Rifat Osmani qëndroi si imam në këtë xhami deri në vitin 2006. Nga viti 2006 krahas angazhimeve të Myftinis arriti të shërbejë në këtë xhami në të gjitha ritet fetare Myftiu Haxhi Edmir Smajlaj.

Xhemati nga dita në ditë sa vjen dhe shtohet. Duhet theksuar se para një viti në oborrin e xhamisë u ndërtua mejtepi i ri i cili do të ndikojë për edukimin e brezave të rinj të këtij fshati me njohuri të përgjithshme Islame. Para një viti me kontributin e xhematit të kësaj xhamie në oborrin e xhamisë janë mbjedhur 22 rrënjë hurma farë zeze.

Fëmijët e këtij fshatit mësojnë në kurset që organizohen nga Myftinia Malsi e Madhe. Gjatë kësaj vere në kursin e organizuar mësuan më shumë se 60 nxënës ku pati një arritje të përgjithshme dhe vlen të përmendet se në konkursin e mbajtur në Tiranë në shkallë republike nxënësit e xhamisë Boriç i Madh u nderuan me çmim të parë në lëndën e besimit.



## PEMA E DOMATES QË JEP NË VIT 3 MIJË TON DOMATE

Në panairin ndërkombëtar shkencor-teknik të agrikulturës që këtë vit është organizuar në provincën Shouguang në lindje të Kinës u prezantua edhe pema e domates që prodhon 3 mijë ton domate në vit.



## NJË KIMIST ZBULON SEKRETIN E VIOLINAVE STRADIVARI



Një shkencëtar në Teksas thotë se ka gjetur sekretin e violinave Stradivari të krijuara 300 vjet më parë në Italinë e Veriut. Ai mendon se l gjithë sekretin është te trajtimi i drurit me disa lëndë të caktuara kimike.

Profesori në pension i Universitetit të Teksasit, Xhozef Nohvari kishte dëshirë të mësonte violinën kur ishte fëmijë, por Lufta e Dytë Botërore dhe ardhja në fuqi e komunistëve në Hungari e bënë të perealizueshme ëndrrën e tij. Pasi iku nga Hungaria ai studioi kimi dhe mësoi të bënte vetë violina.

Duke analizuar violinat e Italisë veriore në vitet 60 ai gjeti se vetëm instrumente të tillë si ato të Stradivarit nga Kremona dhe disa të tjerë të bëra në Venecia i kishin shpëtuar dëmtimit nga krimbi i drurit.

Por zbulimi i tij më i madh erdhi pas bashkëpunimit të tij me kolegët e departamentit të Gjeologjisë në universitetin e Teksasit, të cilët i lanë në dispozicion një aparaturë të teknologjisë së lartë e cila testonte përbërjen kimike të substancave të ndryshme.

Ai merre pjesë shumë të vogla druri të rëna nga violinat Stradivari kur ato riparoheshin, i digjte në laborator dhe pastaj analizonte hirin në aparat duke zbuluar praninë e kimikateve si squfur, klor dhe boron.

Lëndë të tilla përdoren rëndom si kimikate për mbrojtjen e drurit dhe kjoë përforcoi teorinë se duke trajtuar kimikisht drurin, mjeshtrit e vjetër italianë kishin prodhuar pa ditur një instrument të veçantë.

## NJË VIRUS KOMPJUTERIK KËRCËNON LLOGARITË BANKARE



Virus i ri kompjuterik mund t'i zbrazë llogaritë bankare, fillimisht në Rusi, aty ku edhe është diktuar. Këtë njoftoi kompania ruse "Doktor Web".

Sipas kompanisë nëse virusi i cili përfshihet në grupin e "kuajve të Trojës" mund të infektojë softuerët e ndonjë bankomati e kështu do të mund t'i kopjojë të dhënat nga kartelat kreditore të personave që shfrytëzojnë këtë aparat.

Mendohet se në krijimin e këtij virusi janë përfshirë persona të punësuar në banka ose në kompani që prodhojnë softuerë për bankomatë.

## JAPONI: ROBOTI QË LEXOË MENDIMET E NJERIUT

Në Japoni mbërrin një robot në gjendje të lexojë mendimet e njeriut. Testet e para të kryera në Tokio qenë pozitive. Testet u kryen në trototipët e prodhuar nga motorët Honda dhe të pagëzuar me emrin Asimo.

Mekanizmi funksionon falë një sërë elementesh të cilat duke regjistruar variacionin e fluksit të gjakut në varësi të mendimit i lejojnë robotit t'i "lexojë" ato dhe t'i riprodhojë.





## KËRPUDHAT FORCOJNË IMUNITETIN

Studiuesit në Universitetin Shtetëror i Arizonës pohojnë se eksperimentet e realizuara kanë treguar se disa përbërës të kërpudhave kanë ndikim pozitiv në përforsimin e sistemit imun, duke i ndihmuar organizmit në luftimin e infeksioneve dhe tumoreve, shkruhet në revistën shkencore "BMC Immunology".

Gjatë studimit janë vërejtur se efekti pozitiv i kërpudhave vërehet vetëm atëherë kur krijohen procese të ndryshme inflamatore apo zhvillim i ndonjë tumori të zorrës së trashë.



Ekspertët rekomandojnë se për t'u arritur efekti ekuivalent të njerëzit duhet që personat e rritur gjatë ditës të konsumojnë afër 100 gramë kërpudha të papërpunuara.

## PISHINAT TË RREZIKSHME PËR INFEKSIONET INTESTINALE



Infeksionet bakteriale në ngarkim të aparatit gastro-intestinale nuk kanë për origjinë vetëm ushqimin. Mesa duket rreziku për t'u prekur nga infeksionet bakteriale nëpërmjet ushqimit është e barabartë me atë të së infektuarit nëpërmjet notit në pishinë. Të paktën kështu thuhet në një studim, të publikuar në revistën "The Journal of Infectious Diseases", në të cilin janë marrë në shqyrtim rastet e një kampioni prej 298 të rinjsh amerikanë, me moshë me pak se 19 vjeç, të cilët kanë shfaqur infektion intestinal bakterial gjatë 2 viteve. Duke analizuar të

dhënat e testeve laboratorike dhe zakonet e të rinjve, të rinjtë kanë shfaqur një incidencë të lartë ndaj infeksioneve që nuk merren nga ushqimi, me një predominim i shqetësimeve enterike, që shkaktohen nga noti në pishinë.

Gëlltitja e pavullnetshme e ujit, që përmban mikrobe, duket se bëhet një burim i mirë për të

shfaqur shenja të një infeksioni bakterial. Jo vetëm kaq, por edhe kontakti me ujin e një vaskë me lëkurën dhe mukozën mund të shkaktojë infeksion nga *Escherichia coli* apo *Shigella*. Studimi ndihmon në sensibilizimin e frekuentuesve të pishinave, që të mos pinë absolutisht ujë. Gjithashtu rekomandohet përdorimi i vaskave, pasi të jenë dezinfektuar apo dhe larja e duarve pas përdorimit të hidro-sanitareve.

## PESHKU MBRON DIABETIKËT NGA DËMTIMET NË VESHKA

Nëse konsumojnë peshk, diabetikët janë të mbrojtur nga dëmtimet në veshka, që janë shpesh sëmundje që bashkëshoqërojnë diabetin, sidomos atë tip II. Të paktën ky është konkluzioni i një studimi të publikuar në revistën amerikane "American journal of kidney disease". Në një studim të realizuar në Kembrixh, Angli, është marrë një kampion prej mbi 22 mijë vullnetarë, nga të cilët 517 prej tyre vuanin nga diabeti. Vullnetarëve u është kërkuar të shpjegojnë menynë e tyre dhe u pa se konsumimi i peshkut kishte efekte pozitive dhe se ishte e nevojshme që diabetikët të konsumonin të paktën dy porcione peshk në javë. Ndër pacientët që ndiqnin këtë regjim dietetikë, prej dy porcionesh dhe më tepër peshk në javë, studiuesit kanë vërejtur praninë e më pak proteinave në urinë, një kusht që quhet "makroalbuminuria", që është shenjë e dëmtimeve në veshka. Vetëm 8% e tyre kanë shfaqur këtë gjendje, ndërsa pjesa tjetër e diabetikëve që konsumonin më pak peshk, kishin një risk prej 18% për të shfaqur "makroalbuminurin".



## SHËNDETI NË BOTË: RAPORTI "SHOK" I OBSH-SË

Në vendet e Industrializuara, 5 shkaqet kryesore të vdekjeve janë: infarkti, iktusi, kanceri i mushkërive, polmoniti dhe astma bronkiale. Ndërsa në vendet në zhvillim, ndër 5 arsyt kryesore janë: polmoniti, infarkt, diarre, AIDS dhe iktusi. Këto janë vetëm disa nga të dhënat e raportit mbi shëndetin e banorëve të planetit që sapo është publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Duke shfletuar raportin vihet re që në çdo 10 fëmijë që vdesin në botë nga malaria 9 janë afrikanë, që nga 10 fëmijë që vdesin nga AIDS në botë 9 janë afrikanë dhe, gjysma e fëmijëve që lindin në Afrikë vdesin nga diarre dhe polmoniti. E dhënë tjetër është fakti që burrat e të gjithë botës, nga 15 deri 60 vjeç, janë më të kërcënuar të vdesin sesa gratë e të njëjtës moshë, pasi janë më të ekspozuar ndaj vdekjeve të dhunshme apo një ataku kardiak. Ky ndryshim mes burrave dhe grave është më e theksuar në Amerikën Latine, Karaibe, Lindjen e Mesme dhe në Evropën Lindore. Po ashtu në raport theksohet fakti se depresioni prek gati 50 % më tepër gratë sesa burrat, si dhe fakti që në vendet në zhvillim, abuzimi me alkoolin është një nga 10 shkaqet e invalidizimit. "Ky raport lejon institucionet politike dhe shëndetësore të identifikojnë problemet në territorin e tyre, në krahasim me pjesën tjetër të botës dhe të kontribuojnë që t'i drejtojnë forcat për ndryshim aty ku ka më shumë nevojë", shpjegon Colin Mathers, koordinatore e sesionit "Epidemiology and Burden of Disease" të OBSH-së.

## VOTIMET NË MAQEDONI: PARTITË SHQIPTARE FITOJNË 25 % TË PARLAMENTIT

Zgjedhjet u vëzhguan nga mbi 6 mijë vëzhgues të vendit dhe të huaj. Përfaqësuesit ndërkombëtare kanë apeluar për zgjedhje të lira dhe demokratike, duke thënë se mbarëvajtja e tyre është kushti kryesor për integrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE.

Dy jave pas dështimit të zgjedhjeve parlamentare në Maqedoni, me 16 qershor u përsërit dhënia e votave në shumë zona zgjedhore.

Autoritetet thanë se në 184 qendrat e votimit, kanë marrë pjesë 44 për qind e zgjedhësve.

Rezultati i balotazhit nuk ndryshoi rezultatin e përgjithshëm, të zgjedhjeve të 1 qershorit, të cilat u fituan nga Partia konservatore në pushtet VMRO-DPMNE e kryeministrit Nikola Gruevski. Partia konservatore e kryeministrit Gruevski i fitoi zgjedhjet me fitore të dukshme. Forca e tij politike mori 64 vende shumicën e 120 vendeve të parlamentit.

Partitë shqiptare do të përfaqësohen nga 30 deputetë në parlamentin maqedonas. Komisioni Shtetëror Zgjedhor bëri të ditur numrin e saktë të deputetëve që fituan partitë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Bashkimi Demokratik për Integrim do të përfaqësohet në parlamentin maqedonas me 18 deputetë, Partia Demokratike Shqiptare me 11 deputetë dhe Partia për Ardhmëri Evropiane 6me një deputet.

## ARABIA SAUDITE NJEH PAVARËSINË E KOSOVËS

Burime të mirinformuara bëjnë të ditur se Arabia Saudite ka vendosur ta njohë pavarësinë Kosovës, bën të ditur televizioni publik i Kosovës, RTK. Kjo është një njohje më rëndësi të jashtëzakonshme, duke qenë se vjen nga një prej shteteve kryesore të botës islame.

Njohja nga Arabia Saudite shpie numrin e njohjeve në 58-të.

“Në përputhje me lidhjet religjioze dhe kulturore me popullin e Kosovës, dhe në shenjë respekti për vullnetin e popullit të Kosovës për ta fituar pavarësinë, Mbretëria e Arabisë Saudite njofton për njohjen e Republikës së Kosovës dhe shpreson që ky zhvillim do të kontribuojë pozitivisht në përmirësimin e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë si dhe vendeve të saj fqinje”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Arabisë Saudite.

Burimet flasin se publikimi zyrtar i njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e Arabisë Saudite do të mund të ndodh në orët e pasdites.

Gjatë ditës pritet edhe konfirmimi formal-zyrtar, nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.



## SHQIPËRIA NË NATO, TOPI: MIRËNJOHJE PËR ALEATËT QË NA BESUAN



Shqipëria dhe Kroacia u bënë anëtare të NATO-s sot gjatë një ceremonie në Uashington në prani të ambasadorëve të dy vendeve. Ndërkaq, Aleanca e Atlantikut të Veriut ka zyrtarizuar anëtarësimin e Shqipërisë dhe Kroacisë në Aleancë. Tashmë NATO ka në përbërjen e saj 28 anëtarë dhe jo 26. Duke shprehur mikpritjen për dy anëtarët më të reja të Aleancës politiko-ushtarake, NATO siguron përfitime dhe përgjegjësi pas anëtarësimit.

Pas zyrtarizimit, kreu i shtetit ka përshëndetur anëtarësimin, duke falënderuar aleatët dhe duke shprehur sigurinë se bashkë me përgjegjësitë e mëdha, sot Shqipëria ka edhe më shumë aleatë

për përballimin e detyrave dhe angazhimeve.

Presidenti i Republikës Bamir Topi, nga Kopenhagen ku ndodhet për një vizitë zyrtare, përshëndet anëtarësimin e Shqipërisë me të drejta të plota në NATO duke thënë se sot gjithë shqiptarët duhet të falënderojnë të gjitha vendet anëtare të Aleancës që mbështetën dhe ndihmuan Shqipërinë për të bërë realitet ëndrrën e saj euroatlantike. "Të gjithë ne duhet të shprehim sot shumë mirënjohjen ndaj aleatëve tanë sidomos atyre tradicionalë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët na besuan në premtimin tonë integrues. Nga sot, të gjithë shqiptarët kanë më shumë detyra, angazhime dhe përgjegjësi, por kanë më shumë aleatë për t'i përballuar ato me sukses ato"- tha Topi.

Presidenti i Republikës vlerëson hyrjen në fuqi të MSA-së dhe e konsideron këtë çast si hapin me cilësor në institucionalizimin e marrëdhënieve politike, ekonomike, administrative të Shqipërisë me Bashkimin Evropian duke krijuar një terren të sigurt për hapa të mëtejshme drejt anëtarësimit të vendit tonë në Bashkimin Evropian.

"Shqipëria është sot shumë e sigurt për të ardhmen e saj euroatlantike dhe për rikthimin e saj përfundimtar në familjen e demokracive të mëdha euroatlantike" nënvizoi Presidenti i Republikës nga Kopenhagen.

Gjatë ceremonisë Ambasadori i Shqipërisë, Aleksandër Sallabanda dhe ambasadorja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviç përfaqësuan vendet e tyre respektive gjatë kësaj ceremonie të organizuar nga zëvendëssekretari i Departamentit amerikan të Shtetit, James Steinberg. Sllovenia depozitoi të hënën pranë Departamentit amerikan të Shtetit instrumentin e ratifikimit që mundëson anëtarësimin e Kroacisë dhe po kështu bëri edhe më 3 mars për Shqipërinë.

"Depozitimi i instrumentit të ratifikimit nga Sllovenia plotëson procesin individual të ratifikimit nga 26 aleatët e NATO-s, i nevojshëm për pranimin e Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO", njoftoi të hënën Departamenti amerikan i Shtetit.

Pas ratifikimit të pranimit të Kroacisë nga Greqia në mes të shkurtit, Sllovenia ishte vendi i fundit nga 26 anëtarët e NATO-s, nga e cila pritej drita e gjelbër.